# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5937
E premte, 22 nëntor 2019
çmimi 0.40 €


## Rritet interesimi për projektet e financuara nga WBF-ja FAQE 3




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


### NJOHËSIT E PROCESEVE ZGJEDHORE TREGOJNË SE KU DUHET TË NDRYSHOJË LIGJI PËR ZGJEDHJET NË KOSOVË FAQE 4-5

# REFORMA ZGJEDHORE, E DOMOSDOSHME PËR ZGJEDHJET E ARDHSHME



Njohësit e proceseve zgjedhore kanë vlerësuar se zgjedhjet e 6 tetorit kanë treguar nevojën urgjente për një reformë të mirëfilltë zgjedhore. Mazllum Baraliu, Fadil Maloku, Blerim Burjani, Florian Dushi dhe Shpend Emini kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se ndryshimi i ligjit për zgjedhjet është i domosdoshëm për ruajtjen e kredibilitetit të zgjedhjeve. Sipas tyre, reforma e cila duhet t'i prekë çështjet teknike dhe përmbajtjesore të procesit zgjedhor duhet të jetë prioritet i qeverisë së ardhshme

## Policia shpall në kërkim dy persona për vrasjen e Oliver Ivanoviqit FAQE 7



## Procesi i rinumërimit të votave pritet të përmbyllet të dielën FAQE 3

Zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valmir Elezi, ka bërë me dije se përfundimi i rinumërimit të 1 407 kutive të votimit është paraparë të përfundojë në fillim të javës së ardhshme mirëpo, sipas tij, gjasat janë shumë reale që këtë të diel të përmbyllet ky proces



### OPINION

**A DO TË NDËRTOHET KAMP NOU NË KORROTICË APO SANTIAGO BERNABEU NË BËRRNICË?** F. 10

Shkruan: Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



### AKTUALE

**HARADINAJ: QEVERIA E RE E KA TË TEJKALUAR PRESIONIN TAKSË** F. 7

**MË 28 NËNTOR NË DRENAS VENDOSEN SHTATORET E SHABAN, HAMËZ DHE ADEM JASHARIT** F. 6



### EKONOMI

**KEDS-i LICENCOHET PROFESIONALISHT PËR SIGURI E SHËNDET NË PUNË** F. 9

**KURTI: PAGA MINIMALE DUHET TË PËRCAKTOHET PAS NJË STUDIMI TË TREGUT** F. 9

### SPORT

**IDE TË NDRYSHME PËR STADIUMIN KOMBËTAR** F. 16




RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Meta për Kushtetuesen: Rama ka vetëm një zgjidhje, referendumin



TIRANË, 21 NËNTOR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka deklaruar se zgjidhja e vetme për zhbllokimin e ngërçit të krijuar me reformën në drejtësi, veçanërisht në Gjykatën Kushtetuese, është referendumi. "Ka vetëm një zgjidhje për Ramën dhe disa palaço ndërkombëtarë: referendumi. Shqiptarët duhet ta marrin në dorë sovranitetin e vendit. Këtë punë e vendosin shqiptarët", ka thënë Meta.

Sa i përket vendimit të marrë të enjten nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit për shkarkimin e Besnik Muçit nga detyra, anëtar i Gjykatës Kushtetuese, Meta ka pohuar se nuk ishte i surprizuar duke akuzuar zyrtarët e qeverisë. "Ju e dini që vettingu i partisë u shpall para pak ditësh nga zëvendëskryeministri (Erjon Braçe) për z. Muçi. Nuk jam i habitur sepse që kur ka hyrë në zyrë (Muçi) ka pasur presione të drejtpërdrejta për t'u bërë pjesë e puçit për ta bllokuar Xhaferllarin", është shprehur ai.

Insistimit të gazetarëve për t'i thënë emrat e atyre që janë pjesë e këtij puçi të pretenduar, Meta iu përgjigj duke cituar deklaratën e Fatmir Xhafajt, deputet i Partisë Socialiste, mbi Vitore Tushen, e cila është kryetarja në detyrë e Gjykatës Kushtetuese. Sa iu përket kritikave ndaj ambasadorëve, Meta ka thënë se disa prej tyre turpërojnë shtetet nga vijnë, ndërsa për ShBA-në u shpreh: "ShBA-ja është si yll, si shpirt, sepse me të e kemi bërë reformën".

# Majlinda Bregu: Duhet t'i çmontojmë barrierat brendapërbrenda rajonit

PRISHTINË, 21 NËNTOR (ER) - Sekretarja e Përgjithshme e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC), Majlinda Bregu, ka marrë pjesë në një debat panelistësh të nivelit të lartë për marrëdhënien në mes të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së në Zagreb të Kroacisë. Ajo ka thënë se si Evropa ashtu dhe Ballkani Perëndimor janë duke ndryshuar demografikisht si një model i vendeve 'dërguese' dhe 'pritëse', meqenëse pjesa më e madhe e rreth 230 000 qytetarëve kanë migruar ligjërisht nga rajoni drejt BE-së vetëm në vitin 2018. "Ndërkohë që më se 5 milionë (ose 1 e 4 e popullsisë aktuale të rajonit) kanë migruar gjatë shtatë vjetëve të fundit. Po ta shtojmë edhe numrin e të rinjve, këto shifra janë edhe më të larta: pavarësisht se 61 për qind e tyre e mbështesin integrimin e rajonit në BE, ata nuk po humbasin kohë. Duke pasur parasysh se 35 për qind e të rinjve të rajonit janë të papunë (dyfishi i nivelit të papunësisë në BE), 62 për qind e të rinjve do të dëshironin të largoheshin e të punonin jashtë shtetit (BB 2019). Këto janë shifra alarmante për rajonin. Megjithatë, ato flasin në mënyrë de facto për europianizimin demografik të popullsisë së saj", ka thënë Bregu në debatin e panelistëve të nivelit të lartë "Ballkani Perëndimor dhe BE-ja: Sfidat e Përbashkëta dhe Përgjegjësitë e Ndara" të cilin ajo i moderoi si pjesë të Kongresit Statutor të përvitshëm të Partive Popullore Evropiane (PPE) 2019.

Bregu ka theksuar se RCC-ja është tërësisht e angazhuar për bashkëpunim rajonal. "Besojmë se gjërat mund të ecin përpara dhe se këto tendenca shqetësuese mund të kthehen mbrapsht. Pavarësisht se bashkëpunimi rajonal merr kuptim vetëm atëherë kur destinacioni përfundimtar është integrimi në BE, ne duhet të vazhdojmë të punojmë së bashku duke lidhur tregjet dhe popujt, duke lejuar lëvizjen e lirë të qytetarëve, mallrave e shërbimeve në të gjithë rajonin, duke përmirësuar sistemet tona arsimore në mënyrë që t'i plotësojmë nevojat e tregjeve të punës, duke fuqizuar gratë, duke mobilizuar të rinjtë në proceset vendimmarrëse, duke përfshirë edhe aspektin social në veprimtaritë tona - duke çmontuar barrierat brendapërbrenda rajonit tonë. Duke arritur të gjitha këto e



shumë të tjera do të bëjmë që njerëzit të qëndrojnë dhe ata që tashmë janë larguar, të kthehen e ta japin kontributin e tyre në zhvillimin e shoqërive tona sepse, në fund të fundit, ç'mund të jenë tokat pa njerëzit?!", ka thënë Bregu.

Panelistët debatuan lidhur me marrëdhënien në mes të Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Evropian (BE), duke synuar të hidhnin më shumë dritë e të ofronin zgjidhje për sfidat e përbashkëta, si: migracioni, papunësia e të rinjve dhe fenomeni i ikjes së trurit, si dhe për të diskutuar rreth përgjegjësive të përbashkëta që ndajnë BE-ja dhe Ballkani Perëndimor.

# Kimi merr miratimin e Komisionit të Jashtëm të Senatit për ambasadore në Shqipëri




TIRANË, 21 NËNTOR - Komisioni i Senatit për Marrëdhënie me Jashtë ka miratuar emërimin e diplomates Yuri Kim për postin e ambasadores së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri. Për t'u bërë zyrtar, emërimi i saj duhet të miratohet nga Senati. Komisioni votoi për 15 emërime, përfshirë për të emëruarin për postin e ambasadorit amerikan në Rusi, John Sullivan.

Kimi ishte emëruar për ambasadore në Shqipëri nga presidenti Donald Trump në qershor të këtij viti, Në një seancë para Komisionit të Jashtëm të Senatit për konfirmimin e saj në fund të tetorit, ajo tha se do t'i nxiste udhëheqësit e vendit për ta zgjidhur ngërçin aktual politik në mënyrë që të forcohet perspektiva e hapjes së negociatave të anëtarësimit në BE. Kimi shtoi se do ta inkurajonte Shqipërinë t'i zbatonte plotësisht reformat në drejtësi, përfshirë kontrollin e figurës së gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe krijimin e strukturave të posaçme për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

## Avokati i Popullit vlerësohet institucioni më i besuar në vend



PRISHTINË, 21 NËNTOR - Institucioni i Avokatit të Popullit, me rastin e shënimit të 19-vjetorit të themelimit, mori lëvdata të shumta për punën e bërë ndër vite, derisa për të u tha se është institucioni më i besueshëm në Kosovë dhe rajon.

Avokati i Popullit, Hilmi Jashari, tha se institucioni i Avokatit të Popullit falë përvojës së grumbulluar për 19 vjet ka arritur të shndërrohet në institucionin më të besuar në vend dhe Ballkan. Sipas tij, ky institucion do të vazhdojë t'i trajtojë sfidat që lidhen më të drejtat e njeriut e për të cilat ka hartuar edhe plane e strategji që kjo beteje të kalojë me sukses.

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, Arta Rama, tha se ky institucion përmes inicimit të rasteve të ndryshme ka ndihmuar në zbatimin e kushtetutshmërisë në vend. Sipas saj, Avokati i Popullit dhe Gjykata Kushtetuese janë universe paralele që garantojnë të drejtat e njeriut.

Lëvdata për punën që e ka bërë institucioni i Avokatit të Popullit për 19 vjet punë ka shprehur edhe përfaqësuesi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Richardo Serri, i cili ka thënë se Avokati i Popullit në Kosovë është ndër institucionet më të besueshme jo vetëm në vend, por edhe më gjerë.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Procesi i rinumërimit të votave pritet të përmbyllet të dielën

Zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valmir Elezi, ka bërë me dije se përfundimi i rinumërimit të 1 407 kutive të votimit është paraparë të përfundojë në fillim të javës së ardhshme mirëpo, sipas tij, gjasat janë shumë reale që këtë të diel të përmbyllet ky proces



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka bërë me dije se rinumërimi i 1 407 kutive të votimit mund të përfundojë më herët sesa që ishte pritur.
Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka bërë me dije të enjten për "KosovaPress" se i gjithë procesi ishte planifikuar të përfundojë të hënën e ardhshme, por në bazë të dinamikës së deritanishme ky proces pritet të përfundojë një ditë më herët. "Besojmë se më shpejt sesa kemi planifikuar po arrijmë ta përfundojmë rinumërimin e votave. Ka qenë e planifikuar që deri të hënën të përfundojë i gjithë ky proces, por mund të themi se gjasat janë shumë reale që edhe të dielën të përmbyllet rinumërimi i më shumë se 1 407 vendvotimeve për të cilat ka vendosur PZAP-i. Duke qenë se kanë mbetur për t'u rinumëruar 438 vendvotime, pasi deri të mërkurën në mesnatë janë rinumëruar 969 vendvotime apo 68.87 për qind, po besojmë se procesi i rinumërimit mund të përmbyllet një ditë më herët, të dielën", ka thënë Elezi.
Një ditë më parë kryetarja e KQ-së, Valdete Daka, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se ky institucion padrejtësisht po akuzohet për zvarritje të procesit zgjedhor. "Ajo që dua të them është se KQZ-ja padrejtësisht po akuzohet vetëm pse e kryen punën e vet. Do t'ua rikujtoj të gjithë atyre që drejtojnë akuza ndaj KQZ-së, se vendimin për rinumërimin e këtyre vendvotimeve e ka marrë PZAP-ja e ne vetëm jemi duke e zbatuar një vendim të një instance më të lartë. Pra, i kemi pasur rezultatet e gatshme dhe i kemi shpallur ato. Subjektet politike pastaj kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre për t'u ankuar. Pas kësaj ankese ka ardhur një vendim i PZAP-it, në bazë të të cilit jemi obliguar t'i rinumërojmë 1 407 kuti të votimit. Ne nuk jemi duke e zvarritur këtë proces. Ne jemi duke e kryer punën tonë, rinumërimin e votave ashtu siç është kërkuar. Vetë subjektet kanë kërkuar që të bëhet rinumërimi dhe tash kur PZAP-i e ka aprovuar një kërkesë të tillë, ne akuzohemi se po e zvarritim procesin zgjedhor. Këtë nuk po mund ta kuptoj", ka thënë Daka.

# Rritet interesimi për projektet e financuara nga WBF-ja




Zëvendësministrja e Punëve të Jashtme, Rejhan Vuniqi, ka thënë se interesimi për projektet e financuara nga Fondi i Ballkanit Perëndimor (WBF) ka shënuar rritje. Këtë deklaratë ajo e ka dhënë të enjten në sesionin e tretë informues të Fondit të Ballkanit Perëndimor me rastin e thirrjes së tretë dhe të fundit informuese për projektpropozimet rajonale

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës të enjten është mbajtur sesioni i tretë informues i Fondit të Ballkanit Perëndimor (WBF) me rastin e thirrjes së tretë dhe të fundit informuese për projektpropozimet rajonale.
Zëvendësministrja e Punëve të Jashtme, Rejhan Vuniqi, ka thënë se Fondi i Ballkanit Perëndimor, i cili tash e një vit kryesohet nga Republika e Kosovës, është krijuar me qëllim të promovimit të zhvillimit të bashkëpunimit më të ngushtë dhe fuqizimit të lidhjeve në mes të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, integrimit të rajonit në Bashkimin Evropian dhe prezantimin e përbashkët të WBF-së te vendet e treta. "Jemi të lumtur që interesimi për projektet e financuara nga WBF ka shënuar rritje dhe se tani, kur kanë mbetur më pak se dy muaj deri në përfundimin e kryesimit, Kosova bëri një udhëtim të shkëlqyeshëm dhe ka luajtur një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm dhe bashkues gjatë gjithë rrugëtimit", ka thënë zëvendësministrja Vuniqi.
Ndërkaq drejtor i WBF-së, Gjergj Mura, para të pranishmëve ka theksuar se ky projekt është për të gjithë dhe se duhet të punojnë së bashku që të arrihen suksese. "Arsyeja pse jemi këtu është sepse Kosova e ka presidencën e Fondit Ballkanik për vitin 2019. Dua ta shfrytëzoj këtë mundësi për ta falënderuar znj. Vuniqin dhe të pranishmit e tjerë për këto angazhime. Jam i sigurt që në të ardhmen, me mbështetjen e Prishtinës si partenere e fondit tonë, do të arrijmë më shumë rezultate. Është në dorën tuaj të propozoni projekte dhe të arrini suksese. Do t'ju kisha lutur të jeni më kërkues dhe që t'i pyesni ekspertët tanë për informatat që ju nevojiten", ka thënë Mura.
Fondi për Ballkanin Perëndimor (WBF) është krijuar me qëllim të promovimit të zhvillimit të bashkëpunimit më të ngushtë dhe fuqizimit të lidhjeve në mes të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, integrimit të rajonit në Bashkimin Evropian dhe prezantimin e përbashkët të WBF-së te vendet e treta. Republika e Kosovës e ka marrë kryesimin njëvjeçar të WBF-së që nga data 1 janar 2019.



Njohësit e proceseve zgjedhore tregojnë se ku duhet të ndryshojë Ligji për Zgjedhjet në Kosovë

# REFORMA ZGJEDHORE, E DOMOSDOSHME PËR ZGJEDHJET E ARDHSHME

**Njohësit e proceseve zgjedhore kanë vlerësuar se zgjedhjet e 6 tetorit kanë treguar nevojën urgjente për një reformë të mirëfilltë zgjedhore. Mazllum Baraliu, Fadil Maloku, Blerim Burjani, Florian Dushi dhe Shpend Emini kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se ndryshimi i Ligjit për Zgjedhjet është i domosdoshëm për ruajtjen e kredibilitetit të zgjedhjeve. Sipas tyre, reforma e cila duhet t'i prekë çështjet teknike dhe përmbajtjesore të procesit zgjedhor duhet të jetë prioritet i qeverisë së ardhshme**

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valdete Daka, ish-anëtarët e KQZ-së dhe njohësit e proceseve zgjedhore kanë ftuar subjektet politike që, pas konstituimit të institucioneve të reja, ta fillojnë menjëherë reformën zgjedhore. Ata kanë bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se një reformë e mirëfilltë zgjedhore është e domosdoshme për zgjedhjet e ardhshme në mënyrë që të eliminohen të metat e ligjit aktual për zgjedhje të cilat kanë çuar në zgjatjen e procesit zgjedhor të 6 tetorit.

Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valdete Daka, ka bërë me dije se ky institucion do t'i ndihmojë subjektet politike në këtë proces duke ua ofruar ekspertizën për këtë reformë. "Në mënyrë që në të ardhmen të mos kemi një proces i cili nuk do të zgjatë kaq shumë, duhet të kemi një reformë zgjedhore në të cilën do të qartësohen afatet ligjore për ankesat, arsyet për të cilat mund të bëhen ankesat apo të rregullohet më ndryshe procedura e ankimimit. Po në këtë reformë duhet të përfshihen edhe çështje të tjera që kanë dalë në pah gjatë këtij procesi zgjedhor, si votimi me postë dhe çështje të tjera të cilat ndërlidhen me votimin jashtë Kosovës", ka thënë Daka, duke shtuar se këto dilema duhet të hiqen një herë e mirë. "Pra, të gjitha këto duhet të jenë tema për reformën zgjedhore pasi të konstituohen institucionet e reja. Mesazhi im për subjektet politike është që sa më parë të bëhet reforma zgjedhore, të zgjidhen njëherë e përgjithmonë këto dilema dhe këto anomali që kanë dalë në pah gjatë këtij procesi zgjedhor", është shprehur ajo.

Edhe ish-udhëheqësi i KQZ-së, Mazllum Baraliu, reformën zgjedhore e sheh si imperativ të kohës. Madje, sipas tij, një gjë e tillë duhet të jetë prioritet i qeverisë së re. "Reforma elektorale është imperativ kohe, e pashmangshme dhe imediate. Qeveria e re duhet ta ketë reformën zgjedhore ndër prioritetet e para nëse dëshiron ta avancojë demokracinë si dhe të ketë mungesë të gabimeve që po ndodhin. Ka shumë gjëra që duhet të reformohen dhe kjo do të bëhej më së miri me përpilimin e një kodi zgjedhor ku do të përfshihen Ligji për zgjedhjet e përgjithshme, Ligji për zgjedhjet lokale, Ligji për financimin e partive politike dhe rregullat zgjedhore të KQZ-së", ka thënë



Baraliu.
Njohësit e procesit zgjedhor kanë treguar edhe aspekte të tjera se ku duhet të ndryshohet Ligji për Zgjedhjet. Ish-anëtari i KQZ-së, Fadil Maloku, ka deklaruar për gazetën se në reformë duhet të përfshihet depolitizimi i KQZ-së. "Këtu më së shumti janë bërë vërejtjet brendapartiake, pra te komisionet partiake sesa në mes të partive. Pra, vërejtjet ndaj procesit kryesisht kanë qenë për vjedhje brenda llojit. Kjo na bënë të jemi shumë të kujdesshëm dhe ta shikojmë mundësinë e një reforme të mirëfilltë zgjedhore, e cila do ta ndryshonte ligjin aktual zgjedhor", ka thënë ai.
Maloku ka vlerësuar se me këtë ligj janë organizuar shtatë palë zgjedhje dhe tashmë dihen të gjitha dobësitë e këtij ligji. "Vetëm një reformë e mirëfilltë zgjedhore do t'i eliminonte anomalitë e sistemit aktual zgjedhor. Tanimë kemi organizuar disa palë zgjedhje me këtë ligj dhe i kemi vërejtur mirë dobësitë e këtij ligji. Në reformën e ardhshme zgjedhore do të duhej të eliminohej përfaqësimi politik në KQZ. Anëtarët e KQZ-së nuk do të duhej të ishin përfaqësues të subjekteve politike. Anëtarët e KQZ-së do të duhej të ishin gjyqtarë të dëshmuar në karrierën e tyre. Paramendoni 40 për qind të anëtarëve në KQZ përfaqësojnë komunitetet, kurse 60 për qind përfaqësojnë shqiptarët. Kjo nuk ndodh askund në botë", ka thënë ai, duke shtuar se edhe komisionarët duhet të jenë apolitikë.
Depolitizim të KQZ-së ka kërkuar edhe ish-anëtari tjetër i KQZ-së, Blerim Burjani. Ai ka vlerësuar për gazetën "Epoka e re" se probleme në numërimin e votave do të ketë derisa të ndodhë një reformë gjithëpërfshirëse zgjedhore. "Gjithmonë ka pasur probleme të tilla dhe do të ketë edhe në të ardhmen derisa nuk bëhet një reformë zgjedhore gjithëpërfshirëse, e cila do të përcaktojë që komisionarët nuk duhet të jenë partiakë, por shërbyes civilë", ka thënë Burjani.
Edhe ish-anëtari tjetër i KQZ-së, Florian Dushi, ka bërë me dije për gazetën se këto zgjedhje kanë treguar se nevoja e ndryshimit të ligjit zgjedhor është urgjente. "Unë vazhdimisht kam kërkuar të kemi një reformë të mirëfilltë zgjedhore, por këto zgjedhje kanë treguar se ajo tashmë është e domosdoshme për ta ruajtur të pacenuar sistemin demokratik e parlamentar në vendin tonë për ta ruajtur, në fund të fundit, qëllimin pse zgjedhjet organizohen në një vend. Institucionet tona, subjektet politike, duhet me urgjencë dhe seriozitet ta nisin këtë proces, duke marrë për bazë dhe përshtatur nevojave të vendit tonë, standardeve dhe praktikave më të mira të shteteve të cilat tashmë kanë arritur të ndërtojnë, konsolidojnë dhe avancojnë sistemin e tyre demokratik, duke përfshirë edhe rekomandimet e misioneve të vëzhguesve të BE-së", ka thënë ai. Sipas Dushit, reforma është përgjegjësi e të gjitha subjekteve politike. "Reforma zgjedhore duhet të jetë prioritet i qeverisë së re, por është përgjegjësi e të gjitha subjekteve politike në vendin tonë. Qytetarët e Kosovës me të drejtë presin që ky sistem të përmirësohet, të avancohet në kuptimin e përmbushjes së qëllimit dhe misionit të zgjedhjeve në vendin tonë. Reforma duhet të përfshijë elemente të forta të cilat do ta ruanin të pacenuar integritetin e zgjedhjeve, i cenuar së fundmi dhe i kërcënuar në të ardhmen nga të njëjtit faktorë për të cilët folëm më sipër", është shprehur Dushi.
Kurse drejtori i Institutit të Demokracisë për Zhvillim (D4D), Shpend Emini, ka treguar se reforma duhet t'i prekë çështjet përmbajtjesore dhe ato teknike. "Reforma zgjedhore përmendet pas çdo procesi zgjedhor, pasi disa prej parregullsive janë përsëritur që nga viti 2010, kur ka qenë edhe hera e fundit që është punuar në reformë, pa marrë parasysh fillimin e punës në reformë gjatë këtij viti i cili u ndërpre për shkak të shpërndarjes së Kuvendit. Një reformë e cila do t'i prekë jo vetëm çështjet teknike, por edhe ato përmbajtjesore, mund t'i eliminojë parregullsitë të cilat mund të ndikojnë në humbjen e besimit në procesin zgjedhor", ka thënë ai, duke treguar se çka duhet të bëhet me procesin e numërimit. "Në lidhje me parregullsitë e shkaktuara gjatë numërimit si organizatë (D4D) në vitin 2013 patëm rekomanduar që çështja e numërimit të centralizohet, pra që kutitë të mos hapen në vendvotime, por ato të barten, për shembull, në QNR dhe numërimi të bëhet aty, për t'u ikur parregullsive të mundshme, e sidomos manipulimeve të mundshme nga ana e komisionarëve", ka thënë Emini.
Çështja e reformës zgjedhore është aktualizuar pas zgjatjes së procesit zgjedhor të 6 tetorit. Reforma zgjedhore prej vitit 2010 ka qenë kërkesë permanente e BE-së ndaj institucioneve të Kosovës.

# Matoshi në Shkup: Reduktimi i ndotjes së ajrit, sfidë për rajonin

**Shkup, 21 nëntor (ER)** - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, me ftesë të ministrit të Mjedisit të Maqedonisë Veriore, Naser Nuredini, dhe Bankës Botërore, po merr pjesë në konferencën rajonale që për temë ka ndotjen e ajrit dhe gjetjen e zgjidhjeve më të mira në reduktimin e ndotjes.
Para të pranishmëve të kësaj konference ministri Matoshi ka prezantuar sfidat e shtetit të Kosovës dhe veprimet që shteti ynë po ndërmerr për reduktimin e ndotjes së ajrit. Matoshi ka deklaruar se Republika e Kosovës ka marrë disa vendime për reduktimin e përdorimit të thëngjillit për ngrohje, ka filluar fazën testuese për kontrollimin e gazrave që lirojnë veturat dhe ka filluar projektin për ndërrimin e filtrave të TC "Kosova B", të financuar nga Bashkimi Evropian si dhe projektet e zgjerimit të rrjetit të kogjenerimit, në mënyrë që qytetarët të mos kenë nevojë ta përdorin thëngjillin për ngrohje. "Përveç veprimeve që kemi ndërmarrë e po ndërmarrin për reduktimin e ndotjes së ajrit, fokus të veçantë jemi duke i dhënë edhe informimit të drejtë të publikut mbi cilësinë e ajrit. Kështu, falë përkrahjes së Bashkimit Evropian kemi instaluar softuerin për paraqitjen e të dhënave në kohë reale nga stacionet që kemi në Kosovë, po ashtu kemi bërë edhe vendosjen e monitorëve në kryeqytet, ku qytetarët mund të informohen rreth ndotjes së ajrit, njëkohësisht edhe për pasojat e ndotjes së ajrit në shëndet", ka deklaruar Matoshi.
Edhe në këtë konferencë, sikur në konferenca të tjera rajonale dhe globale, ministri Matoshi ka kërkuar që Kosova të ketë qasje në fondet globale të mjedisit, duke vlerësuar se ndotja e ajrit nuk njeh kufij dhe kështu, sipas tij, duhet të jemi të bashkuar për krijimin e një mjedisi të pastër. Në fund ai ka falënderuar donatorët ndërkombëtarë për përkrahjen që po i japin Kosovës për përmirësimin e cilësisë së ajrit, në mesin e tyre, MCC-në, JICA-në, Bashkimin Evropian, Bankën Botërore, UNDP etj.
Konferenca do të vazhdojë të trajtojë aspekte të veçanta të ndotjes së ajrit përmes prezantimeve të studimeve që janë bërë nga ekspertët e pranishëm.



# Më 28 nëntor në Drenas vendosen shtatoret e Shaban, Hamëz dhe Adem Jasharit



Drenas, 21 nëntor (ER) - Komuna e Drenasit ka njoftuar se në bashkëpunim me Komunën e Skenderajt dhe nën përkujdesjen e presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, më 28 nëntor do të bëhet zbulimi i shtatoreve të heronjve Shaban, Hamëz dhe Adem Jashari. Vendosja e shtatoreve të heronjve Jashari do të bëhet në sheshin "Fehmi Lladrovci" në Drenas, duke filluar nga ora 12:00, me ç'rast do të ketë edhe program artistik. "Po ashtu, për nder të festës së 28 Nëntorit dhe zbulimit të shtatoreve do të mbahet seancë e përbashkët solemne e Komunës së Drenasit dhe Skenderajt. Ftohen qytetarët dhe mediat që të nderojnë me pjesëmarrjen e tyre në shënimin e kësaj ngjarje", ka njoftuar Komuna e Drenasit.

## Legalizohet objekti i parë në Rahovec



Rahovec, 21 nëntor (ER) - Drejtori i Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Komunën e Rahovecit, Rumir Zhuniqi, ka bërë me dije se ka nënshkruar vendimin e parë për legalizim të një objekti. Këtë veprim Zhuniqi e ka marrë pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe të udhëzimeve administrative. Ai u ka bërë thirrje qytetarëve të Rahovecit që t'i fillojnë procedurat për legalizimin e objekteve të tyre pa leje. "Pas miratimit të ligjit të ri për trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe hyrjes në fuqi të udhëzimeve administrative dhe nisjes së legalizimit të objekteve pa leje, sot në cilësi të drejtorit të Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit nënshkrova vendimin e parë për legalizim. Objekti i parë që u legalizua ka një hapësirë prej 330 metrash katrorë. Ftesës për legalizim të objekteve u janë përgjigjur shumë qytetarë të Rahovecit e të zonave rurale, të cilat me bashkëpunëtorë po i trajtojmë me kujdes që procedura të aplikohet brenda afateve ligjore dhe në pajtim me ligjin në fuqi. Shfrytëzoj rastin që edhe një herë t'i ftoj të gjithë bashkëqytetarët e mi që ta nisin procesin e legalizimit nëse kanë në pronësi objekte pa leje. Legalizo ndërtimin, mos e humb mundësinë!", ka shkruar Zhuniqi në llogarinë e vet në "Facebook".

## Ahmeti, qytetarëve: Mos i parkoni veturat në vendpunishte, përndryshe ju konfiskohen







Prishtinë, 21 nëntor (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka treguar se në disa lokacione në qytet janë duke punuar për rregullimin e hapësirave të parkingjeve të lagjes. Këtë e ka bërë me dije përmes një postimi në profilin e vet në "Facebook", duke lutur banorët që t'i largojnë veturat dhe mos të parkojnë në vendpunishte, në të kundërtën thotë se do t'i konfiskojnë veturat. "Në disa lokacione në qytet jemi duke punuar për rregullimin e hapësirave të parkingjeve të lagjes. Parkingu te rruga 'Qamil Hoxha' në qendër dhe 'Iliaz Kodra' në Dardani janë dy prej tyre, prandaj lusim banorët që t'i largojnë veturat dhe të mos parkojnë në vendpunishte. Në të kundërtën, detyrohemi t'i konfiskojmë veturat. Falënderojmë banorët për mirëkuptim dhe bashkëpunim, në mënyrë që punimet të realizohen në afat të planifikuar", ka shkruar Ahmeti.

# Hapet Qendra e 13-të Informuese për Shëndetin e Gruas edhe në Obiliq

Obiliq, 21 nëntor (ER) - Në një ceremoni zyrtare janë hapur dyert e Qendrës Informuese për Shëndetin e Gruas "Klasat për Nëna" në Obiliq, në Qendrën e Mjekësisë Familjare (QKMF). Kjo iniciativë është bërë e mundshme falë financimit të Ministrisë së Shëndetësisë në Kosovë dhe bashkëpunimit me Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Obiliqit dhe fondacionit Action for Mothers and Children.

Qendra e 13-të "Klasat për nëna", e hapur tani edhe në Obiliq, do të ofrojë shërbime edukative, aktivitete të mirëqenies fizike dhe psikike, informacione këshilluese për kujdesin para dhe pas lindjes, depresionin e pas lindjes, ushqyerjen me gji, kujdesin për të sapolindurin, të ushqyerit e foshnjës, imunizimin si dhe kujdesin ndaj fëmijës. "Duke e marrë parasysh rëndësinë që qasja në informata shëndetësore ka për shëndetin e gruas dhe fëmijëve, ne po angazhohemi që përmes qendrave informuese për shëndetin e gruas të jemi sa më afër prindërve të rinj në mënyrë që t'u japim këshilla për një shtatzëni të shëndetshme dhe rritje sa më të mirë të foshnjës. Kjo qendër në fokus të veçantë do t'i ketë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas që jetojnë në Obiliq, ku edhe qasja e këtyre komuniteteve në shërbime shëndetësore është e limituar për shkak të kushteve socio-ekonomike", u shpreh Vlorian Molliqaj nga Action for Mothers and Children



Qendra Informuese në Obiliq është e hapur çdo ditë pune për të gjitha gratë e vajzat e Komunës së Obiliqit si dhe partneret e tyre.

# Policia shpall në kërkim dy persona për vrasjen e Oliver Ivanoviqit

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Drejtoria për Hetimin e Krimeve të Rënda, në bashkëpunim me Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), është duke hetuar rastin e vrasjes së Oliver Ivanoviqit. "Me autorizim të Prokurorisë Speciale, Policia e Kosovës publikon fotografitë e dy personave të dyshuar për rastin 'vrasje' të datës 16/01/2018 në Mitrovicën e Veriut. Policia e Kosovës kërkon nga qytetarët e Republikës së Kosovës që kushdo që ka informacion për personat e dyshuar në fotot e bashkangjitura, të lajmërojë Policinë e Kosovës përmes numrit konfidencial të telefonit 080019999, adresën elektronike info@kosovopolice.com ose të paraqiten në stacionin më të afërt policor", është bërë me dije në njoftimin e Policisë së Kosovës.

Sipas këtij njoftimi, publikimi i këtyre fotografive bëhet me qëllim të identifikimit nga ana e qytetarëve të cilët mund ta ndihmojnë policinë rreth identitetit të këtyre personave të dyshuar.

Më 16 janar të vitit 2018 Oliver Ivanoviq u qëllua për vdekje pranë zyrës së vet në Mitrovicën e Veriut. Ai ishte lider i iniciativës qytetare Liria, Demokracia, Drejtësia. Policia e Kosovës deri më tani ka arrestuar disa persona në veri si të dyshuar në lidhje me këtë rast.

Në gusht të këtij viti ministri në detyrë i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka thënë se i dyshuari kryesor për vrasjen e Oliver Ivanoviqit është Milan Radoiçiq, nënkryetar i Listës Serbe. Radoiçiq ndodhet në arrati përderisa ai është intervistuar për këtë rast nga Policia e Serbisë.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka thënë se "shteti serb dhe policia mund të thonë me siguri se Millan Radoiçiq, nënkryetar i Listës Serbe, nuk e ka vrarë politikanin serb nga Kosova, Oliver Ivanoviq".

Foto e dy personave në rrugën Lola Ribar Mitrovicë- veri



# Haradinaj: Qeveria e re e ka të tejkaluar presionin taksë



PRISHTINË, 21 NËNTOR (ER) - Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, u është përgjigjur zërave që po kërkojnë heqjen e taksës ndaj Serbisë. Ai përmes një shkrimi në llogarinë e ve në "Facebook" ka shkruar të enjten se Kosova sot në njëvjetorin e vënies së taksës 100 për qind ka fituar shumë pasi, sipas tij, ka fituar prodhuesi, blerësi ynë dhe ka fituar flamuri ynë. "Është për të ardhur keq që sot shpirtrat e shitur dhe argatët e Serbisë së madhe, në qarqe të ndryshme, duke folur gjuhën tonë, të shqiptarit, i japin të drejtë vetes dhe tentojnë ta influencojnë opinionin, duke kalkuluar interesa të tjera, që assesi nuk janë të Kosovës dhe, përveç të tjerash, janë në dëm të saj, duke prodhuar lajme si formë presioni për ta hequr taksën, për ta dobësuar Kosovën dhe për ta rrezikuar integritetin e saj", ka shkruar Haradinaj. Ai ka thënë se qeveria e re, kushdo që e drejton atë, e ka të tejkaluar presionin taksë "sepse atë për një vit e kemi bartur ne, duke i thënë jo çdo skenari të dëmshëm për dobësim. Efekti 'taksë' ka dhënë frytet edhe në forcimin politik të vendit, siç ka dhënë efekt përplasja dhe kundërshtimi i vazhdueshëm i ndarjes së Kosovës", ka shkruar Haradinaj.

Më 6 nëntor të vitit të kaluar Qeveria në largim e Kosovës vendosi taksën prej 10 përqindësh për prodhimet me origjinë nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina, kurse më 21 nëntor kjo taksë u rrit në 100 për qind për të gjitha produktet dhe mallrat e importuara nga këto dy shtete.

# Ambasadori britanik njoftohet me rezultatet e Zyrës Kombëtare të Auditimit

PRISHTINË, 21 NËNTOR (ER) - Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, Besnik Osmani, ka pritur të enjten në takim ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Republikën e Kosovës, Nicholas Abbott. Në këtë takim Auditori i Përgjithshëm e ka njoftuar diplomatin britanik për punën dhe rezultatet e Zyrës Kombëtare të Auditimit, në veçanti është diskutuar për çështjet kryesore që kanë rezultuar nga puna audituese dhe ndikimi i rekomandimeve për ta rritur llogaridhënien dhe qeverisjen e mirë të institucioneve.

Osmani ka falënderuar Ambasadën Britanike që në vazhdimësi e ka përkrahur Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe është angazhuar që përmes projekteve konkrete t'i ngritë kapacitetet e kësaj zyre. Ndërkaq ambasadori britanik, Nicholas Abbott, ka inkurajuar Auditorin e Përgjithshëm dhe auditorët që ta vazhdojnë punën e mirë dhe ta japin kontributin për përmirësimin e vazhdueshëm për menaxhimin e mirë të financave publike, rritjen e transparencës në administratë publike dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët.





## Nenonatologjia furnizohet me 13 inkubatorë dhe pesë infratavolina

PRISHTINË, 21 NËNTOR (ER) - Në Neonatologji kanë arritur inkubatorë të rinj, sipas kërkesës së klinikës, e bazuar në nevojën për aparaturë shtesë, në mënyrë që të ofrohen shërbime të mjaftueshme dhe më cilësore për fëmijët e lindur para kohe. "Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës ka blerë 13 sosh, njëri prej tyre inkubator transportues dhe pesë infratavolina", është bërë me dije në njoftimin e QKUK-së. Sipas këtij njoftimi të QKUK-së, furnizimi i Qendrës Klinike Universitare dhe spitaleve të përgjithshme me aparaturë të re është parë e domosdoshme nga menaxhmenti i ShSKUK-së për ta përmirësuar gjendjen në ofrimin e shërbimeve dhe përmirësimin e kushteve të punës për profesionistët shëndetësorë.

# Kurti: Paga minimale duhet të përcaktohet pas një studimi të tregut

PRISHTINË, 21 NËNTOR (ER) - "Pas zgjedhjeve të 6 tetorit dhe fitores së Vetëvendosjes do të kemi në qeverisje subjektin e parë socialdemokrat në Republikën e Kosovës që edhe si pjesë të programit e ka mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të punëtorëve", ka thënë drejtuesi i SMJ-së në Lëvizjen Vetëvendosje, Kreshnik Ahmeti, i cili ka ndihmuar në organizimin e këtij bashkëbisedimi të parë në mes të liderit të LV-së, Albin Kurti dhe përfaqësuesve të sindikatave të punëtorëve, ku janë shpalosur problematikat, shkeljet dhe propozimet konkrete për t'i kaluar ato e mbrojtur punëtorët.



Kurti ka thënë se qeveria e ardhshme do të punojë për forcimin e sindikatave për shkak se ashtu mbrohen më së miri të drejtat e punëtorëve nga arbitrariteti i punëdhënësit. Ai ka theksuar se ndër veprimet e para të qeverisë së ardhshme do të jenë sundimi dhe respektimi i ligjit, rritja e inspektorëve të punës dhe krijimi i Gjykatës së Punës që trajton shkeljet e mëdha dhe ato të vogla që duhet të gjykohen e të dënohen.

Kurti ka folur edhe për kontratën kolektive dhe pagën minimale. Ai ka thënë se qeveria e re do ta mbështesë kontratën kolektive, por ka theksuar se duhet synuar që ato kontrata të jenë sektoriale dhe pjesë përbërëse e kontratave të punës. Sipas Kurtit, negocimi i tyre nga sindikatat duhet të jetë shkallor dhe sektorial në mënyrë që të jetë i drejtë dhe fer. Për pagën minimale ai kujtoi se është e domosdoshme që shteti të mos rrijë si spektator, por të ndërhyjë dhe ta rregullojë tregun e punës.

Kurti ka shtuar se paga minimale është tejet e rëndësishme dhe ajo duhet të përcaktohet pas një studimi të tregut që do të mundësonte edhe një kategorizim më të lehtë të nivelit dhe konsultim të të gjitha palëve. "Paga minimale duhet të përcaktohet për numrin e orëve, duhet të jetë në harmoni me kontratën kolektive dhe me Ligjin e Punës dhe duhet ta mbrojë edhe dinjitetin e punëtorit dhe produktivitetin në punë", është shprehur Kurti.

Ai ka shtuar se vendimi i ri duhet të jetë i qartë, i detajuar dhe i saktë. "Ai duhet të definojë saktë se çka është paga minimale, si kalkulohet dhe si do të ndryshojë. Ne besojmë se vendimi duhet të marrë për bazë orët në punë e jo ditët e muajt dhe duhet të synohet që paga minimale të rregullohet për sektorë të ndryshëm. Qeveria duhet që para vendimit të ofrojë një studim të qëndrueshëm me përfshirje të Këshillit Ekonomiko-Social, sindikatat, shoqërinë civile, studiuesit dhe grupet e interesit. Pra, një dialog social duhet t'i paraprijë vendimit dhe ky dialog duhet të jetë shkencor dhe shterues", ka thënë Kurti.

Përfaqësuesit e sindikatave që morën fjalën në këtë bashkëbisedim shtruan problemet që lidhen me mungesën e ligjeve, moszbatimin e Ligjit të Punës, mungesën e kontratave, orët e punës pa pagesë, mungesën e pushimeve, dallimet në paga, mosrespektimin e marrëveshjeve me punëtorët dhe sindikatat, problemet në sektorin privat, kërcënimet dhe shantazhet nga pushtetit si dhe vdekjen e punëtorëve në vendin e punës. Për këto dhe shumë çështje të tjera ata dhanë propozime konkrete duke shprehur gatishmërinë për të bashkëpunuar me qeverinë e re për përmirësimin dhe përparimin e të drejtave të punëtorëve.

# Mbahet 'Panairi i parë i punës dhe karrierës' në Universitetin 'Isa Boletini'

MITROVICË, 21 NËNTOR (ER) - Organizuar nga Qendra për Zhvillim të Karrierës dhe mbështetur nga GIZ-i, është mbajtur të enjten "Panairi i parë i punës dhe karrierës" në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini" (UMIB). Në këtë aktivitetet kanë marrë pjesë kompani private, kompani publike si dhe janë prezantuar fakultetet e UMIB-it.

Në ceremoninë e hapjes së panairit, rektori i UMIB-it, Alush Musaj, ka falënderuar kompanitë për pjesëmarrje dhe bashkëpunim. "Bashkëpunimi ndërmjet universitetit dhe biznesit jo që është nevojë, por imperativ. Sa më shumë që ofrohemi si botë akademike dhe si biznes aq më shumë krijohet mundësia për të qenë të suksesshëm të dyja palët. Dhe kur ne jemi të suksesshëm, atëherë është e suksesshme edhe vetë shoqëria", ka thënë ai. Sipas tij, UMIB-i është duke provuar që të hapet sa më shumë për biznesin, për idetë e tyre dhe për përvojën e tyre. Ai ka theksuar se po provojnë të përshtaten me kërkesat dhe nevojat e tregut, në mënyrë që studentët të jenë të gatshëm dhe të përgatitur për trendët e rinj. Në këtë kontekst, ai përmendi se, përveç programeve, kabineteve, laboratorëve që ofrohen në UMIB, një segment tepër të rëndësishëm paraqet bashkëpunimi me kompanitë publike dhe ato private në vend. i rrjedhojë, ka thënë se studentët mund ta kryejnë praktikën në kompanitë që ndërlidhen me natyrën e studimeve, duke e zënë shpejt hapin e teknologjisë së re.

Rektori Musaj ka thënë se ndërsa ngjarjet sikur "Panairi i punës dhe karrierës" jo vetëm që e pasurojnë kalendarin e aktiviteteve universitare, por në të njëjtën kohë hapin shtigje të reja. "'Panairi i parë i punës dhe karrierës' në universitetin tonë është një përvojë e re. Është një mundësi e vendosjes së komunikimit ndërmjet fakulteteve dhe biznesit dhe identifikimit të nevojave të njëri-tjetrit", ka thënë Musaj. Në emër të bizneseve foli Gani Durmishaj nga qumështorja "Aldi", i cili vlerësoi bashkëpunimin e mirë që kanë me UMIB-in. "Kemi vërejtur se studentët janë shumë mirë të përgatitur teorikisht, por që kanë nevojë për mbështetje për punë praktike. Jemi të hapur që ta thellojmë bashkëpunimin me universitetin, ndërkohë që panairi është një mundësi e mirë e identifikimit të mundësive për bashkëpunim", ka thënë Durmishaj.




Përfaqësuesi i GIZ-it, Rrahim Trepça, çmoi organizimin e mirë të panairit dhe premtoi vazhdimin e bashkëpunimit me UMIB-in. "Ky është hapi i parë dhe jemi të vendosur ta thellojmë bashkëpunimin me UMIB-in në të mirë të studentëve dhe stafit akademik". Ndërsa kryetari i Parlamentit Studentor, Ensar Suma, ka thënë se panairi është një mundësi e ofrimit të studentëve me kompanitë që kanë nevojë për kuadro të fushave të ndryshme. "Pa dyshim se ky aktivitet shpërfaq nevojën e shtimit të bashkëpunimit me biznesin për t'u përshtatur më lehtë me kërkesat e tregut të punës", ka thënë ai.

Panairi ka qenë njëditor dhe ka zgjuar interesimin e studentëve dhe të stafit akademik që janë bërë pjesë e kësaj ngjarjeje.

# Mehmeti thotë se një kompani e huaj mund ta rishikojë çmimin e sigurimeve

Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka bërë me dije se kanë lënë edhe një opsion rreth çmimit të tarifave për sigurimin e automjeteve. Ai ka thënë se nëse nuk ka pajtime, një kompani e huaj mund t'i rishikojë çmimet dhe të merret një vendim



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka mbajtur të enjten konferencë për medie, në të cilën ka folur për rritjen e çmimeve për regjistrimin e makinave. Mehmeti ka thënë se vendimin për ngritjen e çmimeve e kanë marrë për t'i shmangur shkeljet ligjore. "Këtë vendim e kemi marrë për t'i mbrojtur polisëmbajtësit nga sektori bankar, nga sektori mikrofinanciar dhe ai financiar", u shpreh Mehmeti. Po ashtu, ai ka thënë se është edhe rekomandim i FMN-së për t'i rishikuar tarifat. "Duke u bazuar me rregullat dhe rekomandimet e FMN-së, ka ardhur rekomandimi që të rishikohen tarifat. Rishikimi i tarifave nuk është bërë që nga viti 2001. Faktori i parë është rritja e dëmeve, rritja e pagesave, aplikimi i sistemit bonus malus e ka rritur inflacionin që nga viti 2012 në 33 për qind, sipas ASK-së. Kompanitë e sigurimeve kanë bërë kërkesë për 35.6 për qind, por ne e kemi refuzuar pasi që nuk i kanë dhënë të gjitha sqarimet. Në vitin 2001, kur është paguar ky prim, ne nuk e kemi pasur pagesën për sigurime në Shqipëri, ku vetëm për vitin 2018 kemi paguar 420 mijë euro sigurime", u shpreh ai. Mehmeti, po ashtu, ka lënë edhe një opsion rreth çmimit të tarifave për sigurimin e automjeteve, e që, sipas tij, kjo çështje mund të zgjidhet dhe me anë të asistencës të një kompanie ndërkombëtare. "Jemi dakord që të rishikohet çmimi, mund të vendosë ndonjë kompani ndërkombëtare. Bordi ekzekutiv e ka marrë një vendim dhe, me qëllim që të jemi transparentë, po atë ditë të vendimit kemi lëshuar një komunikatë, në të cilën janë treguar arsyet e këtij vendimi. BQK-ja është rregullatore mbikëqyrëse, njëkohësisht e ka për obligim ta bëjë edhe rregullimin e tarifave për kompanitë e sigurimeve. Për këtë qëllim, BQK-ja, duke vepruar në përputhje të legjislacionit në fuqi dhe duke respektuar rekomandimet e bëra nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, ka vendosur që të bëhet rishikimi i çmimeve aktuale", është shprehur Mehmeti.

## Sigurimet paguan 400 milionë euro dëme

Shoqata e Sigurimeve të Kosovës (ShSK) me anë të një komunikate për medie ka ripërsëritur dëmet milionëshe të shkaktuara në këtë industri. "Sektori i sigurimeve në vendin tonë edhe më tutje vazhdon të punojë me bilanc vjetor negativ për shkak të shumës së madhe të mjeteve që kompanitë e sigurimeve për çdo vit detyrohet të paguajnë në emër të dëmeve të mëdha që shkaktohen në vend nga automjetet e siguruara, por edhe rreth 100 mijë automjete të pasiguruara sa llogaritet të jenë në vendin tonë", është thënë në komunikatën e ShSK-së. Duke iu referuar të dhënave zyrtare, theksohet se Kosova ka numrin më të madh të automjeteve të pasiguruara se të gjitha shtetet e rajonit. "Bazuar në të dhënat zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), shihet shumë qartë se nga viti 2002 e deri në fund të muajit shtator të këtij viti shuma e dëmeve të kompensuara kalon mbi 400 milionë euro, shifër kjo më e lartë krahasuar me vendet e rajonit. Por, gjatë gjithë këtyre viteve në total të gjitha kompanitë e sigurimit që operojnë në vendin tonë kanë arritur të humbin më shumë se 16 milionë euro. Pra, nëse e nxjerrim një mesatare nga viti 2002 e deri më tash, të gjitha kompanitë e sigurimit që operojnë në vendin tonë gjatë çdo viti kanë humbur rreth 900 mijë euro", është thënë në komunikatën e ShSK-së.

# KEDS-i licencohet profesionalisht për siguri e shëndet në punë



PRISHTINË, 21 NËNTOR (ER) - KEDS-i është licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për ushtrimin e punëve profesionale nga Siguria dhe Shëndeti në Punë. "Licenca i mundëson kompanisë për ta bërë vlerësimin e riskut dhe përpilimin e dokumentit për vlerësimin e riskut, inspektimin dhe testimin sistematik të mjeteve të punës si dhe për përgatitjen e realizimit të programit për trajnimin e punonjësit për kryerjen e sigurt të punës. KEDS-i ka investuar në certifikimin e personave si ekspertë të sigurisë dhe shëndetit në punë në vitet 2017 dhe 2019. Deri më tani janë tetë ekspertë të sigurisë dhe shëndetit në punë, të shpërndarë në shtatë distriktet e Kosovës, kështu duke përmbushur me sukses obligimet ligjore", është thënë në njoftimin për media të KEDS-it.
Me moton zero aksidente në punë, KEDS-i është duke punuar fuqishëm në mirëqenien e punëtorëve të vet. "KEDS-i në vazhdën e rritjes së sigurisë në punë dhe arritjen e këtij misioni ka ndërtuar qendrën e trajnimit ngjitur me Parkun e Biznesit në Drenas. Aty vazhdimisht trajnohen punëtorët e kompanisë në një program që zgjatë katër ditë. Në fund testohen dhe secili prej tyre e ka për obligim t'i kalojë testet me sukses dhe të certifikohet, në të kundërtën rikthehet nga fillimi deri në certifikim. Të njëjtën kohë të gjithë punëtorët janë të pajisur me të gjitha pajisjet mbrojtëse të sigurisë dhe e kanë për obligim t'i kenë me vete vazhdimisht", është theksuar në këtë njoftim.
Sipas KEDS-it, vetëm gjatë dy vjetëve të fundit nga ndërmarrja e këtyre masave për siguri e shëndet në punë kompania ka arritur t'i ulë aksidentet në punë në shkallën 40 për qind. Në bazë të kësaj ecurie parashihet që shumë shpejt ky numër të bie në zero, duke e përmbushur misionin. "Lidhur me këto masa kompania është vlerësuar shumë edhe nga BSPK dhe sindikatat e tjera, edhe nga Inspektorati i Punës. KEDS-i vizitohet vazhdimisht edhe nga kompanitë e rajonit për t'i ndjekur hapat e njëjtë të masave të sigurisë, përkatësisht pajisjet dhe trajnimet", është thënë në njoftimin e KEDS-it.

# A do të ndërtohet Kamp Nou në Korroticë apo Santiago Bernabeu në Bërrnicë?



Shkruan: Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Duelet e "viganëve" të sportit që nuk i njeh as Korrotica e as Bërrnica: Kosova është vend i mrekullive dhe mundësive që nuk i ofron asnjë shtet tjetër në botë. E ka një mbitokë të pasur me intelektualë, analistë të politikës dhe të anatomisë (që vegjetojnë, zhvillohen, mbijetojnë dhe ngritën profesionalisht në anusin e politikanëve e që studiohet nga anatomia), ekspertë për banka, për ekonomi dhe financa, shoqëri civile super të papërlyer, profesorë që kanë grada shkencore të fituara sipas standardeve të Bangladeshit të cilët nuk kanë njohuri elementare gjuhësore se si shkruhet pa gabime as formula e leshit.

Mbi të gjitha, Kosova e ka një nëntokë të jashtëzakonshme siç e kishte edhe Kolumbia e Pablo Eskobarit, Sicilia e Toto, jo Kutunjos por e Rinas, Klani i Zemunit me paramilitarët e Milloshevigit, dikur Bronksi i Amerikës apo sot Sinaloa ose ZETA-s e Meksikos. Kosova, përveçse është dëshmuar si burim i talenteve njihet edhe si vend ku "ekspertët" e këtij lëmi, sportin e kanë futur nën kthetra të politikës sikur që politikën e kanë shndërruar në sport të zhvatjes dhe faturë me të cilën mbulohen njëqindmijë të zeza!

Tash nuk duhet të jesh fort i informuar e ta kuptosh se në planin ekonomik dhe social Kosova nuk e ka asnjë problem të vetëm sikur që në të gjitha fushat ku ofrohen shërbimet jemi bindshëm në vendin e parë! Me gjitha këto të mira , duke mos ditur ç'të bëjmë tjetër e filluam një projekt ; ndërtimin e një stadiumi të futbollit e që të ngjashëm nuk do ta ketë askush në botë. Lëreni ju stadiumin e ndërtuar në Tiranë që në ndeshjen kundër Francës i ndahej shtresa e barit si të ishte petë lakrori, çdoherë kur ndonjë lojtar apo referi shkelte me tërë shputën e këmbës .

E patë një situatë kur gjatë një dueli pak më të fortë, nën këmbët e lojtarit u hapë një gropë sikur në rrugët e Shpend Ahmetit në Prishtinë të cilën pastaj Hysaj mundohej ta mbyllte si të ishte kopshtar e jo lojtar! Kosova nga pësimet e të tjerëve ka nxjerrë mësime, nuk ka pasur nevojë të përsërisë gabimet e të tjerëve. Pastaj, në këtë fushë ka angazhuar ekspertë ndër më të ndershmit në botë sikur që janë udhëheqësit e Federatës, politikanë të të dy krahëve; atij paqësorë dhe të luftës dhe vetëm ka mbetur të përcaktohet për lokacionin.

Krahu i luftës sa ishte në pushtet u përcaktua për Drenicë përkatësisht për Korroticë. Duket të jetë bërë projekti dhe se janë bërë investime fillestare. Tash pas zgjedhjeve të 6 tetorit 2019, krahu "paqësorë", LDK-së duket se do të jetë pjesë e pushtetit bashkë me LVV apo me dikë tjetër, nuk ka aspak rëndësi me kënd, me rëndësi të jeni në grazhdin e pushtetit, ka deklaruar se Stadiumi nuk do të ndërtohet në Korroticë, por në Bërrnicë. Kemi përballje të dy "viganëve" të sportit; Bekim Haxhiu apo Kamishi i Drenicës dhe Lumir Abdixhiku apo Miri i Xhikës. Përveçse kanë qenë jashtëzakonisht të talentuar, si shpresa të futbollit kosovarë dhe botërorë, që të dy janë intelektualë të spikatur, Kamishi si profesor në fakultetin ku lind dhe vdesë humanizmi, Fakulteti i Mjekësisë ndërsa Miri i Xhikës është ekspert në fushën ku numërohen, dhe pa asnjë gjurmë humbin paratë, në Fakultetin e Ekonomisë. Që të dy përveç përkushtimit në fushën e sportit njihen edhe si aktivistë politikë që janë në majat e kupolës - Ndragetës së politikës kosovare, për një kohë të gjatë. Kamishi i Drenicës e ka bërë luftën e fundit, kurse Miri i Xhikës jeton me kujtimet e luftës së parafundit. Gjaku ujë nuk bëhet! Që të dy këta burra të shquar të kombit kosovar janë edhe biznesmenë të suksesshëm, por se për shkak të modestisë se tyre nuk identifikohen në publik si të tillë duke e respektuar statusin e tyre njerëzorë, kombëtar, politikë, intelektualë dhe afaristë!

Çka i bashkon dhe çka i ndanë Korroticën dhe Bërrnicën: Këto të dy lokacione janë pjesë përbërëse e territorit të Kosovës sikur që të dyja këto duan që stadiumi të ndërtohet në lokacionin e përfolur. Mendoj se vetëm këto dy pika i bashkojnë këto lokacione.

Në anën tjetër, Korrotica si pjesë e Drenicës heroike është burim i të gjitha përpjekjeve për çlirim, liri, drejtësi, barazi dhe pavarësi, si rrugëtim kalimtar drejt gjakimit të gjithë shqiptarëve përjashtuar këtu kosovarët, bashkimit kombëtar që llogaritet si e drejtë e njeriut, e dhënë nga Zoti dhe nga natyra. Drenica e dha formën, kuptimin dhe përmbajtjen e lirisë. Po të mos ishte Drenica, liria nuk do të banonte në Kosovë dhe as shqiptarë nuk do të kishte në Kosovë. Drenica e sakicës së Ahmet Delisë, e urisë së Shotë Galicës, e opingave të shqyera të Azem Bejtës, e gjymtyrëve të mërdhira të Shaban Polluzhës dhe Mehmet Gradicës por të shpirtit liridashës dhe sakrifikues, Drenica e Tahir dhe Nebih Mehës, kurbanëve të qëndresës, Drenica e dy gjigantëve të trimërisë, sakrificës dhe shqiptarisë, Fehmi dhe Xhevë Lladrovci dhe Drenica e simfonisë së këngës për liri edhe në çaste kur shkonin drejt amshimit të komandantit legjendar Adem Jashari dhe tërë familjes legjendare Jashari, bashkë me mysafirë që ishin edhe luftëtarë sikur edhe me të tjerë që kurrë nuk iu ndanë komandantit legjendar, Adem Jashari, meriton më shumë respekt.

Meriton më shumë investime, si në ruajtjen e kujtesës historike ashtu edhe në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Drenicës të cilët, sipas një paragjykimi të shëmtuar politesk, janë të paracaktuar vetëm për sakrifica.

Është koha e ndryshimit të këtij stereotipi që e përdorin hoxhallarët kur u drejtohen besimtarëve ; në këtë botë duhet të vuani në mënyrë që në botën tjetër t'i gëzoni gjitha të mirat , tokë , krimba dhe të tjera që janë shoqërues të të vdekurve. Për këtë arsye, ndonëse në asnjë mënyrë nuk e konsideroj se është prioritet ndërtimi i stadiumit, megjithatë jam që në Drenicë të ndërtohet stadiumi e jo në Bërrnicë. Bërnica është krejtësisht e kundërta e Korroticës sepse aty ka qenë burimi i robërisë ku Serbia kishte njësi paramilitare ushtarake dhe politike. Duhet, njëherë e mirë të pamundësojmë manipulimin e politikës në instrumentalizimin e sportit në përgjithësi kurse, në rastin konkret të futbollit në veçanti.

Nuk duhet të lejohet që lojën e ndyrë politike ta bartin në fushën e sportit. Asgjë nuk paraqesin në sport, as Kamishi e as Miri i Xhikës, po përpiqen të bëhen faktorë vetëm përmes politikës . Që të dy, kontributin më të madh që mund të japin për sportin kosovarë është që të qëndrojnë sa më larg, dhe në rast se shkojnë në stadium, atëherë duhet t'i paguajnë biletat e jo të shvercovaten si VIP-a! Të bëhemi të sinqertë e të mos riciklojmë pamjet që zgjatnin 1-2 orë duke brohoritur: Jemi me ty Drenicë, kurse tërë kohën tjetër e kalonim duke u shoqëruar me Draganin, Stojanin dhe Millanin duke pirë shlivovicë në Bërrnicë!

# Në Mitrovicë përurohet qendra e rinovuar e Shoqatës Down Syndrome Kosova



**Mitrovicë, 21 nëntor (ER)** - Nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, i shoqëruar nga drejtori për Financa dhe Zhvillim Ekonomik, Shukri Gashi, të enjten kanë marrë pjesë në përurimin e hapësirave të rinovuara për ofrimin e shërbimeve për fëmijët me sindromën Down, në Qendrën e Shoqatës Down Syndrome Kosova, në Mitrovicë. Me këtë rast, nënkryetari Mujka ka falënderuar donatorët të cilët kanë kontribuar në rinovimin e kësaj qendre, duke thënë se me të vërtetë këta fëmijë meritojnë përkujdesje dhe kushte sa më të mira për një edukim të mirëfilltë për ta.

Po ashtu, nënkryetari Mujka ka theksuar se Komuna e Mitrovicës para disa ditësh ka nënshkruar kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për krijimin e një qendre për personat me aftësi të kufizuara, duke e bërë atë funksional dhe hapësira në fjalë të ofrojë shërbime për personat me aftësi të kufizuara.

Ndërsa përfaqësuesit e kësaj qendre u shprehën të jenë mirënjohës dhe falënderues ndaj institucioneve, bizneseve, miqve dhe bashkëpunëtorëve që ndihmuan në rinovimin e që, falë kontributit të tyre, u krijuan kushte më të mira pune për anëtarët dhe stafin e DSK-së në Mitrovicë.

Rinovimi i kësaj qendre është mbështetur nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në kuadër të projektit "Dreams Academy", Shoqatës Bamirëse "Djemtë e Mitrovicës" si dhe nga qytetarët e vullnetit të mirë.

OBELISKU I MIRËNJOHJES QË I MUNGON KOSOVËS (5)

# Lobit shqiptar në Amerikë Kosova i ka borxh Obeliskun e Mirënjohjes



Shkruan: Bedri ISLAMI

Udhëheqja politike e lëvizjes çlirimtare, edhe përmes takimeve jozyrtare me struktura të nivelit të dytë të diplomacisë ndërkombëtare, ka qenë e bindur se fillimi i luftës në atë kohë do të kishte pasuar pasoja të tmerrshme për popullin e Kosovës jo vetëm se gjërat nuk ishin përgatitur por, mbi të gjitha, në atë kohë, ndihej mungesa e një politike të qartë të Shteteve të Bashkuara dhe të Bashkimit Evropian jo vetëm ndaj shtetit serb, por edhe ndaj Kosovës.

Udhëheqja politike e lëvizjes paqësore në atë kohë kishte nevojë të domosdoshme për njohje, sidomos përtej Atlantikut. Ajo ndiente nevojën e një përkrahje solide të lobit shqiptar në këtë vend dhe, përmes tyre, të figurave të njohura të politikës amerikane që do të lobonin për të.

Sikur në Kosovë, në vitet 1992-1993 do të ndizej lufta. Ajo do të kishte pasur një fund të përgjakshëm në jetët njerëzore dhe të mjerueshëm në fatin politik të Kosovës. Ajo mund dhe do të bëhej kurbani i vogël i një paqeje të madhe.

Tragjeditë e luftës në Bosnje i treguan Perëndimit se masakra të tilla nuk duheshin lejuar dhe, duke përfituar nga kjo situatë, kur gjërat po dilnin më hapur, duke dëshmuar një makineri vrastare serbe, ishte e qartë se Perëndimi nuk do të lejonte përsëritjen e tyre, ose do të duhej të hiqte përfundimisht dorë nga deviza e saj për liritë dhe të drejtat e njeriut.

Ishte koha kur vetë Perëndimi kërkonte një rrugë të mesme, mes Pavarësisë së Kosovës dhe Gjendjes nën pushtim, të cilat i cilësonte njëlloj të rrezikshme si vatra lufte, por që ende nuk e kishte gjetur as zgjidhjen e duhur dhe as bashkëbiseduesin e duhur në Beograd.

Milloshevigi kishte ardhur në pushtet duke tundur kartën e Kosovës, ai do të binte nga pushteti nëse kjo kartë i binte nga dora.

Precipitimi i ngjarjeve, kur në Kosovë ishin krijuar dy polet e politikës, lëvizja paqësore dhe lëvizja çlirimtare, që kishin njëlloj përkrahësit e tyre tek lobi shqiptar në Amerikë, do të bënte që shumë shpejt, qendra e gravitetit e politikës dhe e diplomacisë amerikane të zhvendosej në Prishtinë.

Fillimisht përmes Zyrës së Posaçme Amerikane në Prishtinë, si një njohje jo zyrtare e aspiratës së shqiptarëve për mëvetësi dhe si kapërcim në një fazë të re të përpjekjeve të lobit shqiptar në Amerikë. Do të ishte zyra e parë e këtij niveli, që më pas do të pasohej nga ndonjë zyrë tjetër, por që kishte përmbledhur gjithë ndikimin e politikës amerikane në këtë rajon që do të nxehej shumë shpejt.

Përciptasi disa veprimtari të diplomacisë amerikane në Kosovë në muajt e parë të vitit 1998: Në janar 1998 do të shpallet iniciativa e Robert Gelbardit, të deleguarit special të ShBA-së për ish-Jugosllavi për refuzimin e gjendjes së status quosë në Kosovë dhe mospranimin e kërkesës së shqiptarëve për pavarësi,duke gjetur një zgjidhje të pranueshme.

Më 2 mars 1998 në Prishtinë do të jetë zoti Nick Hill, sekretari i parë në Ambasadën e ShBA-së në Beograd, njohës i mirë i gjendjes në Kosovë, i cili solli vlerësimin e Departamentit të Shtetit se "lufta ka filluar dhe se duhet ndërmarrë diçka sa nuk është tepër vonë". Ai do të sjellë idenë e krijimit të Grupit Negociator...

Më 6 mars 1998 do të bëhet takimi i veçantë i diplomatëve amerikanë, Gelbard dhe Hill, dhe ambasadorët e Grupit të Kontaktit me udhëheqjen politike pacifiste në Kosovë, duke kërkuar vendosjen e një ure lidhëse me forcat çlirimtare.

Të nesërmen, më 7 mars 1998, në Prishtinë do të venë urgjentisht ambasadori Richards Miles, shef i Misionit Amerikan në Beograd, Nick Hill, diplomat amerikan, i cili sjell lajmin se gjenerali Wesley Clarck, komandanti suprem i Paktit NATO, do të jetë një ditë më pas në Shkup.

Më datën 9 mars 1998 do të zhvillohet Mbledhja e Grupit të Kontaktit në Londër, e cila i kushtohet tërësisht Kosovës dhe mundësisë së eksplodimit të luftës atje.

Më 10 mars 1998, zoti Gelbard do të jetë në Zyrën Amerikane në Prishtinë për të afruar një zgjidhje në momentin e fundit dhe e kupton se, koncepti i tij i fillimit të janarit dhe shkurtit, për forcimin e pozitës së Rugovës, si shmangie e luftës në Kosovë, tani është i pavlefshëm. Gelbard, pas ngjarjeve në Prekaz, do të bëhet pasues i dorës së fortë si qasje ndaj Milloshevigit, si e vetmja rrugë për zgjidhjen e problemit. Si duket, qasja e tij ishte e shpejtuar dhe nuk përkrahet, të paktën haptasi.

Më 10 mars 1998, me propozimin e të dërguarit amerikan, Grupi i Kontaktit do të vendosë që çështja e hapjes së negociatave për zgjidhjen e problemit të Kosovës, t'i besohet ish kryeministrit të Spanjës, Filip Gonzales.

Më 18 mars 1998 lind, si pasojë e propozimit amerikan, G-15, Grupi-15, me negociatorët shqiptarë dhe, në këtë takim formues, do të jetë i pranishëm edhe zoti Gelbard, i cili do të deklarojë në praninë e zotit Rugova se, ShBA ka përkrahjen e plotë të Britanisë dhe të Gjermanisë për të iniciuar procesin bashkërendues.

Është kjo hapja e parë e problemit në përmasa kaq të gjëra. Fillon e krijohet një hapësirë më e madhe ndërkombëtare për Kosovën. Më 18 mars 1998 diplomati amerikan Gelbard i sugjeron zotit Rugova se kush mund të ishte pjesëtar i Grupit Negociator dhe mes tyre edhe Adem Demaçin. Përpjekja e parë serioze për të lidhur asfaltin, simbolikisht Prishtinën, me malin, simbolikisht Prekazin.

Më 19 mars Zyra Amerikane në Prishtinë deklaron se përkrah dhe do të njohë zgjedhjet e planifikuara për datën 22 mars, si një mundësi për legjitimin e mëtejshëm të rolit të Rugovës.

Një vit më pas, zoti Gelbard do të tregonte se ai e kuptoi shumë shpejt se zoti Rugova mund të krahasohej me një bimë, krejtësisht pasive dhe se për këtë duhej rrethuar me njerëz të dorës së fortë.

Më 26 mars 1998, në mbledhjen e Grupit Negociator shqiptar, do të jenë të pranishëm edhe zotërinjtë Gelbard dhe Greenstock, drejtori Politik në Feriegn Office të Britanisë së Madhe..

Do të vazhdohej gjatë me ditë takimet dhe bisedat e diplomatëve të lartë amerikanë në Kosovë.

Në fare pak kohë Kosova do të bëhej qendra e vëmendjes e diplomacisë amerikane, jo vetëm në Ballkan, por shumë më gjerë.

Diplomatët e njohur, Gelbard, Hill dhe Holbrook, do të jenë të pranishëm në secilën javë në këtë rajon, që nga zyrat e selitë e partive politike legale, të rrugës paqësore për zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe deri në llogoret ku përgatitej lufta.

I jashtëzakonshëm dhe shumë i rëndësishëm ka qenë roli i diplomatit Cris Hill, njeriu që bart mbi vete një përgjegjësi të jashtëzakonshme për mbivendosjen e urave të komunikimit mes dy shtabeve, njërit në Prishtinë dhe tjetrit në Drenicë dhe për shuarjen e çdo mundësie që lufta të eskalonte edhe brenda të njëjtit komb, shqiptarëve.

Zoti Hill, në mënyrë absolute, do të jetë diplomati më i lartë që u bë i pranishëm në të gjitha vatrat e luftës dhe luajti rol të jashtëzakonshëm në gjetjen e rrugëve efikase për të ecur më tej procesi i sendërtimit të projektit të një Kosove jo të pavarur de jure, por të pavarur faktikisht.

Në momentet më të vështira, kur mendohej se nuk do të gjendej një zgjidhje tjetër, zoti Hill do të jetë i pranishëm dhe, përmes njohjeve të shumta që kishte krijuar dhe besimit që kishte fituar, do të jetë njeriu i domosdoshëm, që, jo vetëm përfaqësonte politikën amerikane në një dimension të ri, por edhe përmbysjen e një raporti politik ballkanik, i vendosur dhunshëm, ose përmes pushtimit, ose përmes legjitimit të tij në Konferenca ndërkombëtare.

Merita e jashtëzakonshme e zotit Hill do të jetë në përqendrimin e mendimit politik të shtetit që përfaqësonte në dy anët e rrethit që ishte krijuar, duke shkuar drejt përkrahjes gjithnjë e më të hapur ndaj forcave çlirimtare, si një faktor tashmë jo vetëm ushtarak, por edhe politik, që, një ditë të ardhme, mund të kishte një të nesërme në politikën e Kosovës.

Figura e zotit Holbrook, si më madhorja e diplomacisë amerikane, do të jetë sinjifikative, e domosdoshme në çastet kritike dhe deleguese e mendimit të diplomacisë amerikane përmes një figure fuqiplotë.

Takimi i tij me përfaqësues të Drejtorisë Politike të UÇK-së dhe vajtja e tij në Junik, mes njerëzve të UÇK-së, do të jetë sinjali më i fuqishëm që Perëndimi i dërgonte shtetit serb dhe makinerisë së tij vrasëse, se, kësaj here, ndeshja e tij nuk do të ishte me një formacion etnik shqiptarësh, por se, pas tyre, qëndron edhe forca politike, diplomatike e ushtarake e ShBA-së.

Roli i zotit Gelbard, si i dërguari fuqiplotë në fazën e parë të fillimit të luftës, mund të ndahet në dy momente; para 6 marsit 1998, kur ai mendonte se UÇK-ja, shumë shpejt mund të shpallej terroriste, çka mund t'i jepte dorë të lirë pushtetit të Milloshevigit për masakra të tjera dhe, pas 6 marsit 1998, kur ai vetë e definoi se lufta në Drenicë nuk ishte bërë kundër luftëtarëve që mund të shpalleshin terroristë, por edhe kundër fëmijëve të moshuarve, grave etj.

Qëndrimi i ri i tij, për një qasje ndryshe, në fillim do të ketë ndërshtime në Departamentin e Shtetit dhe roli i tij do të s'postohej gradualisht, por do të jetë sinjali i parë, i qartë dhe i fortë se tashmë, duam apo nuk duam, duhet të llogaritim edhe tek forcat çlirimtare.

Të gjithë këto që përmenda më lart nuk kishin ardhur në Kosovë duke mësuar atje për Kosovën. Ata kishin marrë me vete investime të mendimit politik dhe të diplomacisë së saj, por, mbi të gjitha, ata ishin "dërmuar" nga të dhënat, takimet, bisedat, informacionet dhe afrimet politike që u ishin bërë nga lobi shqiptar në Amerikë.

Ata ishin njohur dhe kishin takuar burra të shquar atdhetarë të fuqishëm, të cilët nuk kishin asnjë interes tjetër. veç përkushtimit të tyre kombëtar; ata ishin pjesë e bisedave pasionante dhe e afishimit të dokumenteve serioze mbi të vërtetën e Kosovës, ndaj edhe ishin më të besuar se gjithë të tjerët.

Lobi shqiptar në Amerikë ishte paradhoma e diplomacisë amerikane ndaj Kosovës dhe çështjes shqiptare në përgjithësi dhe, nga ai Lob, domosdo, kaloi një pjesë e mirë e konceptit të ri për Kosovën, çka solli edhe këtë realitet jashtëzakonisht të paimagjinueshëm, por tashmë të realizuar.

Liria, megjithëse jo e plotë, është në Kosovë. Të plotë, tashmë, mund ta bëjnë vetë shqiptarët, duke mos harruar se, në këtë liri, është përpjekja titanike, e vazhdueshme dhe jetësore e shumë brezave, mes të cilëve janë edhe gjeneratat e pashoqe të lobit shqiptar në Amerikë, ndaj të cilëve, qeveria e Kosovës ka detyrimin e saj atdhetar të ngrejë Obeliskun e Mirënjohjes.

**(Fund)**



## Trumpi: Do t'i bëjë publike të dhënat e mia financiare



**Uashington, 21 nëntor** - Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, ka bërë me dije të enjten se do të publikojë të dhëna mbi financat e tij përpara zgjedhjeve presidenciale të 2020-s, duke shtuar se i takonte atij të vendoste mbi këtë çështje. Njoftimi vjen në një kohë kur Trumpi po përballet me padi dhe thirrje nga përfaqësues të politikës, për të publikuar të dhëna rreth taksave dhe informacione të tjera të lidhura me financat e tij. "Unë jam i pastër dhe kur t'i publikoj deklaratat mbi financat e mia dikur përpara zgjedhjeve, do të tregoj vetëm një gjë, që jam shumë më i pasur nga sa mendonin njerëzit dhe kjo është një gjë e mirë", ka shkruar Trump në llogarinë e vet "Twitter", pa dhënë detaje mbi pretendimet e tij mbi pasurinë që disponon.

# Fiona Hill: Ukraina ndërhyri në zgjedhjet amerikane? Është një trillim i shërbimeve ruse

**Uashington, 21 nëntor** - Ish-zyrtarja e lartë e Këshillit të Sigurisë Kombëtare tha të enjten, gjatë dëshmisë në procesin hetimor ndaj presidentit Donald Trump, se është "një trillim" se Ukraina, dhe jo Rusia, ndërhyri në zgjedhjet amerikane të vitit 2016 në të cilat fitoi presidenti Trump.

Gjatë dëshmisë së saj përpara Komisionit për Zbulimin e Dhomës së Përfaqësuesve, Fiona Hill, kundërshtoi drejtpërdrejt presidentin Trump, i cili është shprehur ndonjëherë se ekzistonte mundësia që Rusia të ketë ndërhyrë në zgjedhje, por se e pranon mohimin nga presidenti Vladimir Putin se Moska pati ndërhyrë për ta mbështetur Trumpin.

Në një telefonatë të zhvilluar më 25 korrik, e cila gjendet tashmë në epiqendër të hetimeve, presidenti Trump i kërkoi presidentit ukrainas Volodymyr Zelenskiy "të na bëjë një favor" duke çelur hetime për një nga rivalët kryesorë demokratë për zgjedhjet e 2020-s, ish-nënpresidentin Joe Biden, si dhe për teorinë e diskredituar se ishte Ukrania që punoi në vitin 2016 për të ndihmuar sfidanten demokrate, ish-Sekretaren e Shtetit Hillary Clinton.

Hill, e cila ishte deri në verë drejtoreshë e lartë për Evropën dhe Azinë në Këshillin e Sigurisë Kombëtare, tha se, "bazuar në pyetjet dhe deklaratat që kam dëgjuar, disa prej jush në këtë komision duket se mendojnë se Rusia dhe shërbimet e saj të sigurisë nuk zhvilluan një fushatë kundër vendit tonë dhe se, ndoshta, për ndonjë arsye ishte Ukraina që veproi kështu. Ky është një trillim që është iniciuar dhe propaganduar nga vetë shërbimet ruse të sigurisë". *(Voa)*




# Donald Tusk zgjedhet kryetar i Partisë Popullore Evropiane

**Zagreb, 21 nëntor** - Donald Tusk, presidenti i ri i partisë më të madhe në Parlamentin Evropian, ka paralajmëruar kundër zgjedhjes së "popullistëve politikë, manipuluesve dhe autokratëve" në role udhëheqëse brenda aleancës.

Tusk, president në shkuarje i Këshillit Evropian, i ka thënë partisë së qendrës së djathtë, Partia Popullore Evropiane, në një Kongres të mbajtur në Zagreb, se ky grup duhet të përkushtohet për ta luftuar "popullizmin e papërgjegjshëm".




Partia Popullore Evropiane është themeluar më 1976 dhe e quan veten aleancë të qendrës së djathtë, në të cilën përfshihen 84 parti dhe partnerë në 42 shtete, si dhe funksionon mbi parimin e "përkushtimit për një Evropë të fortë të bazuar në modelin federal që shtrihet në parimin e decentralizimit".

Ky parim përfshihet edhe në ligjet evropiane, që nënkupton se çështjet politike dhe ato shoqërore duhet të trajtohen në nivelin më lokal të mundshëm.

Pasi është zgjedhur lider i ri, Tusk i ka thënë Kongresit se "në asnjë situatë ne nuk guxojmë që fushën e sigurisë dhe rregullit ta dorëzojmë te populistët politikë, manipulatorët dhe autokratët". "Ne nuk do t'i sakrifikojmë vlerat tona, si liritë civile, sundimin e ligjit dhe jetën publike, sepse nuk kemi nevojë. Kushdo që nuk mund ta pranojë këtë gjë, në fakt është duke vendosur veten jashtë familjes", ka thënë ai.

Tusk nuk ka përmendur liderët me emra, mirëpo kryeministri i Hungarisë, Viktor Orban, ka bërë thirrje si lider i të djathtës ekstreme për një lëvizje populiste kundër migrimit në gjithë kontinentin, sidomos në Evropën Qendrore dhe atë Lindore.

Partia Popullore Evropiane ka pezulluar anëtarësinë e Partisë Fidesz të Orbanit nga aleanca pasi Orbani ka udhëhequr një fushatë të ashpër kundër Presidentit të Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker.

Ende nuk është bërë e qartë nëse kjo aleancë do ta dëbojë partinë Fidesz.

## 'Google' do t'i kufizojë reklamat politike

**Nju Jork, 21 nëntor** - Gjiganti 'Google' nuk do të lejojë që fushatat politike të shënjestrojnë njerëz bazuar në qëndrimet e tyre të supozuara politike. Kjo politikë do të nisë së zbatuari në Mbretërinë e Bashkuar "brenda një jave" duke vazhduar më pas me rajone të tjera. Megjithatë, fushatat për reklamim do të mund të shënjestrojnë persona bazuar në moshë, gjini dhe lokacion.

Kjo kompani ka thënë se do të marrë masa edhe për qëndrimet mashtruese në reklama, të cilën nuk e ka bërë rrjeti social 'Facebook'.

Mark Zuckerberg ka thënë se nuk do ta analizojë vërtetësinë e fushatave të kandidatëve politikë që bëhen në 'Facebook'.

Rrjeti tjetër social 'Twitter' ka njoftuar se nuk do të lejojë fare fushata të reklamimit.

Politika e re e 'Google' e vendos këtë kompani në situatë për të vepruar vetëm kur mashtrimet janë të shkallës së lartë. "Ne e pranojmë se dialogu politik është pjesë e rëndësishme e demokracisë dhe se askush nuk mund ta gjykojë secilin pretendim politik apo kundërpadi", ka thënë udhëheqësi i Departamentit për Reklama në 'Google', Scott Spencer. "Prandaj ne presim që numri i reklamave politike të cilat do t'i rishikojmë do të jetë shumë i kufizuar, mirëpo ne do të vazhdojmë ta bëjmë këtë gjë për t'i shmangur shkeljet", ka thënë ai.




Shijo
Pranverën
me...
Jaffa Champion PLUS
A+C+E
Multifrutti
Taste of World Wide Brand!
2L
Jaffa Champion


AUTOSHKOLLA
“RITMO – L”
Auto Shkolla
“RITMO - L”
Prishtinë
Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.
Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333

E rrallë

## NASA gjen sheqer në meteor



Meteorët që u rrëzuan në tokë miliarda vjet përmbajnë sheqerna, sipas studiuesve. Një ekip ndërkombëtar shkencëtarësh gjeti sheqerna në meteor, të cilët përmbajnë edhe përbërës të tjerë biologjikisht të rëndësishëm, ka njoftuar NASA në një njoftim për medie.

FOTO E DITES



Në fotografi shihet një fushë e gjimnazit në kompleksin e Universitetit Politeknik në Hong Kong pas përfundimit të një proteste nga disa nxënës. /AP/

E jashtëzakonshme

## Gjykata franceze u jep të drejtë rosave të bëjnë 'kuak-kuak'



Rosat në një fermë të vogël franceze mund të vazhdojnë të bëjnë "kuak-kuak", madje sa të duan, pasi një gjykatë franceze ka vendosur në favor të tyre, duke refuzuar padinë e ngritur nga një fqinj, që ankohej se zhurma e zogjve po ia shkatërronte jetën. Gjykata në qytezën Dax ka vendosur se zhurma që vinte nga tufa prej rreth 60 rosash dhe patash, që rriteshin nga një fermer në pension, në buzë të një kodrine në Pirenej, në Francën jugperëndimore, ishte brenda limiteve të pranueshme. Padia ishte paraqitur në gjykatë nga një fqinj i fermerit që ishte zhvendosur nga qyteti në fshat rreth një vit më parë, në një pronë rreth 50 metra larg nga vendi ku mbahen rosat. Ai kish kërkuar marrjen e masave për reduktimin e zhurmës dhe 3 500 euro dëmshpërblim. Në një tjetër vendim në shtator, një gjel deti i quajtur Moris ishte lejuar të vazhdonte të këndonte në agim pavarësisht prej ankesës së fqinjëve që, po ashtu, kishin ardhur në fshat nga qyteti.

## BARSOLETA E DITËS



**Gruaja: O Zot ma merr shpirtin!**
**Burri: Pse more?**
**Gruaja: Sepse ti je i marrë!**
**Burri: Unë jam, po pse të ta marrë Zoti?!**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Vetëm gjatë vikendit në ora 13:00**

### The Addams Family / 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 27 min

**Rolet:** Oscar Isaac, Charlize Theron, Chloë Grace Moretz, Finn Wolfhard, Nick Kroll, Bette Midler, Allison Janney, etj.
**Regjia:** Conrad Vernon And Greg Tiernan







**Çdo ditë në ora 15:00 dhe 17:00**

### FROZEN 2 / 3D

I Animuar/Aventure/Komedi; 1 orë 43 min

**Rolet:** Kristen Bell, Idina Menzel, Josh Gad, Jonathan Groff, Jason Ritter, etj.

**Regjia:** Chris Buck, Jennifer Lee

**Çdo natë në ora 19:00**

### FORD V FERRARI

Aksion/Biografi/Dramë; 2 orë 32 min

**Rolet:** Matt Damon, Christian Bale, Jon Bernthal, Caitriona Balfe, Tracy Letts, Josh Lucas, Noah Jupe, Remo Girone, Ray McKinnon, etj.
**Regjia:** James Mangold







**Çdo natë në ora 21:30**

### TERMINATOR DARK FATE

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 orë 14 min

Rolet: Linda Hamilton, Arnold Schwarzenegger, Mackenzie Davis, Gabriel Luna, Natalia Reyes, Diego Boneta, Edward Furlong, etj.

Regjia: Tim Miller

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Udhëtimet ju kanë larguar aq shumë nga stresi i përditshëm sa edhe relaksimi i një fundjave do t'jua mbajë gjatë atë buzëqeshjen e qetësisë.



**DEMI**
Sot e keni nisur ditën me humor të keq dhe kjo gjë do të ndikojë në çdo plan që keni bërë për orët në vazhdim. Duhet ta rregulloni humorin.



**BINJAKËT**
Të gjithë të lindurit e kësaj shenje sot do të kenë një ditë të qetë dhe plot humor. Në çift ose në punë do të përjetoni surpriza të bukura.



GAFORRJA
Ndjenjat tuaja do të kenë lëkundje të mëdha ditën e sotme dhe vetë ju do të përjetoni çaste tensioni nga pasiguria që ju ka kapur.



**LUANI**
Nga kokë-fortësia juaj sot do t'ju shpëtojë një rast shumë i mirë financiar që do t'i rregullonte mjaft mirë financat tuaja në të ardhmen.



VIRGJËRESHA
Edhe pse tipa komu-nikues zakonisht, sot ju ka zënë plogështia dhe nuk doni të bëni asgjë.



PESHORJA
Sot do të bëni zgjedhje që shkojnë ndesh me ato që vendosni zakonisht. Do të rezultojnë mjaft produktive.



**AKREPI**
Nëse keni mundësi për të mbaruar punë sot mos e neglizhoni. Koha nuk ju premton për të gjitha projektet tuaja.



SHIGJETARI
Sot një çështje financiare do t'ju shkaktojë shumë stres. Nëse ju kap paniku nuk do të arrini të zgjidhni gjë.



**BRICJAPI**
Në ditët e shkuara keni bërë një gabim që do t'ju duhet pak kohë për ta rikuperuar. Gjithsesi do të dini si të veproni.



**UJORI**
Nëse doni të merrni në dorë fatin tuaj sot mundohuni të qartësoni disa situata të dyshimta.



**PESHQIT**
Ditën e sotme duhet të gjeni aleatë të fuqishëm për të mbrojtur një projekt që ka kundërshtitë e veta.

# Ronaldo hedh poshtë zërat e martesës së fshehtë




Pas lajmeve që u përhapën ditën e fundit, të cilat thanë se ylli portugez i futbollit, Cristiano Ronaldo, ishte martuar fshehurazi me Georgina Rodriguezin, sulmuesi i Juventusit i ka mohuar këto fjalë. Burime shumë të afërta me sportistin e famshëm kanë thënë se këto janë thjesht lajme të rreme. Fjalët për dasmën e fshehtë erdhën pak javë pasi Ronaldoja, i cili ka që në vitin 2016 i lidhur me Georginan, tha se ka në plan të martohet me bukuroshen, që do të ishte edhe realizim i ëndrrës së mamasë së tij, Maria dolores dos Santos Aveiro.

# Paris Hiltoni mohon të ketë bërë operacione plastike: Jam e tëra natyrale



Paris Hiltoni ka mohuar të ketë bërë ndonjëherë operacione plastike dhe thotë se ka një sekret tjetër për shkëlqimin rinor. Trashëgimtarja e hotelit, 38 vjeçe, është vetëm disa vjet larg nga ditëlindja e 40, por e ndau sekretin e pamjes sikur është akoma në të 20-tat. Paris, e cila është mike e ngushtë me Kim Kardashianin, thotë se dielli është çelësi për ta mbajtur një shkëlqim rinor.



# Rita Ora: Bashkohuni me mua t'i mbrojmë fëmijët në nevojë

Këngëtarja e njohur nga Kosova, Rita Ora, në Ditën Botërore të Fëmijëve ka thënë se fëmijët nuk duhet të vriten. Këtë e tha me anë të një postimi në rrjetin social "Facebook". "Sot është Dita Botërore e Fëmijëve dhe jam krenare që jam bashkuar me UNICEF-in në Mbretërinë e Bashkuar për t'u bërë thirrje të gjithë liderëve t'u japin fund vdekjeve të fëmijëve! Bashkohu me mua", ka shkruar Rita Ora.

# Anulohen koncertet e Enrique Iglesias mes raporteve për mashtrim



Enrique Iglesias është detyruar t'i anulojë disa koncerte në Evropën Lindore pas raportimeve për mashtrim nga promovuesit. Autori i hitit 'Hero' duhej të performonte në Kroaci, Letoni dhe Bjellorusi në dhjetor, por koncertet janë anuluar papritmas. Një deklaratë e postuar në faqen e internetit të agjencisë letoneze "Bilesu Serviss" pretendon se zëdhënësi i Iglesias në Agjencinë e Arteve Kreative anuloi shfaqjet pasi promovuesit dështuan ta përmbushin marrëveshjen për t'i organizuar koncertet.







| Autor: Gazmend Morina - BENI | PATRIOTI NË FOTO 1 | RILINDËSI VEQILHARXHI | ISH SKITARI ITALIAN TOMBA | | DARKA QË HANË MYSLIMANËT PAS AGJËRIMIT / OPEN ARCHIVES INITIATIVE | BASHKËTING-ËLLORE | QYTET I YNI | EPOKA E RE | LUMË NË SHQIPËRI | SHKRIMTARJA MAMAQI | PELLG A REZERVUAR I HAPËT PËR TË GRUMBULLUAR UJË | I VËNË NË SITË | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| NJË PREJ FIGURAVE STILISTIKE (lit.) | | | | | | | | KËNGËTAR I YNI / INDUSTRIAL EQUIPMENT NEWS | | | | | | | | | |
| DHEU I PËRZIER ME UJË | | | | | | BANOR I KRYEQYTETIT TË ARABISË SAUDITE | | | | | | | | | | | |
| NJË PREJ SHTAT EMIRATEVE QË FORMOJNË *EMIRATET E BASHKUARA ARABE* | | | | | | SHTET FEDERAL NË SHBA / DREMIT NDENJUR | | | | | | | | | | | |
| PATRIOTI PRIZRENI | | | | | HENDEK PËR TË UJITUR (sh.shq.) / SHTET NË "FUND TË BOTËS" | | | | | | | | | | | | |
| BASHKËTING-ËLLORE | | QYTET I LASHTË NË ILIRI / KËNGËTARJA BARAKU | | | | | | LËNGU I SYRIT | INDIUM, URANIUM / ARTI I TË FOLURIT | | | | | | | | |
| NAFAKË | | | | KALIBËR I TYTËS SË ARMËS | | | | | | | RODA / GJË E RRALLË E ME VLERË (Lat.) | | | | | | |
| FUTBOLLISTI ANGLEZ FERDINAND | | | | "LETONIA" / EMËR MASHKULLI TË KRISHTERË | | | KOHË E CAKTUAR PËR PUNË / TË ARNUARIT | | | | | KAM DIJENI PËR DIÇKA | ZANORE | JEVG | QESËNDISËSE | QENGJ I BUTË, QË ËSHTË MËSUAR TË NDJEKË PAS BARIUN | GAZ QË SHPËRTHEN KUR DIKUSH TALLET ME DIKË (sh.shq.) |
| ADEM DEMAÇI | | | INTERESI BANKAR NGA KREDIA / AKTORI AMERIKANE MURPHY (shqip.) | | | | | | | ANËTARËSIMI NË NJË PARTI / PËRHAPJE E VALËVE | | | | | | | |
| PATRIOTI POLLUZHA | | | | | | KALORËS MESJETAR (shq.) / ZANORE | | | | | | | GOJOR / SKUQJA E LËKURËS NGA ZGJERIMI I KAPILARËVE | | | | |
| ZANORE | | KËNGËTARI ..... MAKASHI / ESTONIA, AUSTRIA | | | | | | NJËSIA E REZISTENCËS ELEKTRIKE / TROYES | | | | EMËR I VJETËR PËR LUBJANËN / UMA THURMAN | | | | | |
| PORTIERI SPANJOLL PEPE ..... | | | | | | I PËRZIER; I TRAZUAR / ISH FUTBOLLISTI SPANJOLL RUBEN ...... (VALENCIA) | | | | | | | | SHEGË | | | |
| | | | | ELEKTRON, BOR; METËR / KING DAVID SCHOO | | | | PARA TË NËNTIT / DY BASHKË-TINGËLLORE | | | | | | KUNDREJT I VJETËR / "OSASUNA" | | | |
| LLOJ VETURE ITALIANE | DY BASHKË-TINGËLLORE | KRYEQYTETI I GANËS / ALUMIN | | | | | VEPRIMTARI .... HASANI / LLOJ GJARPRI (sh.shq.) | | | | | BASHKË, GRUMBULL A GRUP / VETURA | | | | BASHKËTING-ËLLORE / SHTET NË AZI | |
| AKTORI I FAMSHËM ANTONIO | | | | | | | | | MOLDE / MËNJOLLË, NJOMËZ | | NDODHI QË TREGOHET ME GOJË (keah.) / KA, TER | | | | | | |
| KËSULE E JONA | | | | | ALEN NURI | | | BASHKËTING-ËLLORE / QELQ | | FEMRA QË VALLËZON ME NJË KAVALIER / EMËR YNI MASHKULLI | | | | | IGLI TARE / INTERNATIONAL MARITIME ORGANIZATION | | |
| | | | | | PATRIOTI NË FOTO 2 | | | | | | | | | LUFTËTARJA PALIKUQI / DILETANT | | | |
| | | | | | INSTITUCION I LARTË SHKENCOR | | | | | | | | GURRË (sh.shq.) / DASHURI E THJESHTË DHE E PASTËR (shq.) | | | | |
| | | | | | EPOKA E RE | SHTET NË AZI / SKAJE MAGNETIKE | | | | | KËNGËTARI MUSHKOLAJ / SHPREHI E KEQE | | | | | | KËNGËTARJA CAKULI |
| | | | | | DY BASHKË-TINGËLLORE | | | SHTET FEDERAL NË SHBA / HIT NGA "NRG BAND" | | | | | | | PREZANTUESE E NJOHUR SHQIPTARE | BASHKËTING-ËLLORE / "O" në mes të dy "K" | |
| | | | | | DHOMA E BURRAVE | | | | LËRE (bised.) / KYÇ, NYJE | | | VENDLINDJA E ODISEUT / AKTORI .. PAÇINO | | | | | |
| | | | | | KAFSHË QË JETON NË AMERIKË DHE PËRDORET PËR NGARKESË | | | | | FUTBOLLISTI ....... KALOU (Chelsea) / ZANORE | | | | | | | |
| | | | | | GAZ PANGJYRË DHE PA ERË (shq.) | | | | | | GJINI E LETËRSISË ARTISTIKE | | | | | | |

# Historia e shqiptarëve që e mbrojtën Sanxhakun nga çetnikët

Lufta për mbrojtjen e Pazarit është shprehje e cila ka hyrë në histori si shprehje treguese për zhvillimet luftarake në Sanxhakun e quajtur Sanxhaku i Novi Pazarit, i cili deri në vitin 1912, kur u okupua nga Serbia, ishte pjesë përbërëse e Vilajetit të Kosovës. Në këto luftime, për qëllim të mbrojtjes së popullatës së rrezikuar nga shfarosja, janë ballafaquar trupat e armatosura shqiptare me ato sllave



*Njësitë nga Kosova*

**Ismet AZIZI**

Në Sanxhak në vitin 1941, jetonin rreth 254 mijë banorë. Nga ky numër 57 për qind e popullsisë kanë qenë të besimit ortodoksë dhe 43 për qind myslimane (shqiptarë e boshnjak). Analfabetizmi i popullsisë së përgjithshme ishte në shkallë prej 76 për qind. Në vitin 1931, Sanxhaku kishte në dispozicion shtatë mjekë dhe 171 shtretër në spitale. Prandaj, vdekshmëria foshnjave ishte 142 në 1000 foshnje të lindura.

Parë nga pikëpamja ekonomike, Sanxhaku ishte pjesa më e pazhvilluar e tërë shtetit të atëhershëm, pa asnjë objekt të veçantë industrial, me bujqësi krejtësisht ekstensive. Gjatë dimrit të 1941-1942 mbizotëroi uria e cila ka shkaktuar rritjen e vdekshmërisë së popullsisë. Përveç tjerash, popullsia joserbe e kësaj treve ishte e keqtrajtuar e pa të drejta elementare njerëzore; e urryer dhe duke iu hakmarrë në çdo aspekt ne emër të sundimit osman, e po ashtu duke u trajtuar nga Serbia si element i rrezikshëm dhe i urryer.

Drazha Mihailovic

Në të njëjtën ditë kur kishte kapituluar Mbretëria Jugosllave, më 17 prill 1941, Ushtria gjermane hyri në Pazarin e Ri. Banorët e Pazarit nuk fshihnin kënaqësinë me rastin e ardhjes së gjermanëve, sepse shpresonin se në kuadër të qeverisjes së re do të "frymojnë" më lirisht.

Aqif Blyta, me urtësinë që e karakterizonte, e njofton komandën e lartë gjermane me historinë jo vetëm të Pazarit, por krejt viseve shqiptare, të ndarë padrejtësisht nga shteti amë më vitin 1913. Pas kësaj, trimi i Pazarit do të shihet edhe në tubimet e popullit në Pejë e Mitrovicë ku me fjalën e urtë u tregon për qëllimet e komandës së lartë gjermane, duke i siguruar ata se trupat nuk mund të konsiderohen pushtuese.

E vërteta është (pavarësisht se ç'mund të kenë qëllimet strategjike të Gjermanisë) se me vendosjen e forcave gjermane në territoret e Mitrovicës, Pejës, Pazarit e Rozhajës, masakrat serbe pushuan.

Në malet rreth Pazarit të Ri, kah mesi i vitit 1941 u formuan njësitë të përbëra nga serbët e rrethit të Dezhevës dhe Moravicës. Malet e Kopaonikut, Rogoznës, Golisë, Javorit, si dhe luginat e lumit Ibër në drejtim te Rashkës dhe Kralevës, vlonin nga kriminelët çetnikë me në krye me Dragoljub Mihaloviqin -Drazhën..

Komanda gjermane, duke respektuar të drejtën për autonomi, u lejoi dhe u mundësoi krerëve të Sanxhakut të rikthejnë qeverisjen e cila iu ishte marrë pas Luftës Parë Ballkanike. Në takimin që u mbajt në Mitrovicë, të cilin e kishte organizuar Krajs komanda më 19 prill 1941.,qeverisja politike dhe udhëheqja iu dorëzua myslimanëve të Sanxhakut. Në këtë këshillim morën pjesë Aqif Blyta dhe Ahmet Daci. Vendet kyçe udhëheqëse në kryeqytetin e Sanxhakut - Pazarin, i morën Aqif-efendia, Ahmet Daci dhe Bahri Abdurrahmani (Abdurahmanoviq). Të gjithë pozitat kryesore të cilat më herët i mbanin serbët, i morën sanxhaklinjtë, ndërsa nga xhandarmëria u larguan të gjithë serbët dhe malazezët, sepse Aqifi nuk kishte besim në ta. Largpamësia e tij u tregua më vonë shumë e qëlluar në ngjarjet të cilat u zhvilluan më vonë, si hap me vend në shpëtimin e Pazarit dhe me këtë edhe tërë Sanxhakun - sepse çelësi i mbrojtjes ishte në këtë qytet. Për komandant të xhandarmërisë u emërua Azem Haxhoviq.

jedinice-sabana-poluze

Në radhë të qytetarëve më të respektuar të asaj kohe, pos Aqif Blytës ishin edhe krerët, si: Ahmet Daci, kryeshef i rrethit dhe kryetar komune në Pazarit; Ejup-agë Lajqi; Hafiz Ibrahim Rigjanoviq, gjykatës i sheriatit; Murat - efendia Sukiq, myfti;- Xhemajl agë Bosnja; Mahmut agë Elfiqi.

Egërsirat çetnike pa ndërpre përgatiteshin se si ta thyejnë "zemrën e Sanxhakut" - Pazarin e Ri. Atëherë në krye të Këshillit për mbrojtjen e Pazarit të Ri u vu Aqif Blyta. Këshilla të ngjashëm u formuan në shumicën e qyteteve të Sanxhakut. Aqifi në tërësi kontrollonte situatën në qytet dhe rrethinë. Menjëherë e mobilizoi tërë popullatën e aftë për luftë dhe shpërndau armët dhe në të njëjtën kohë dërgoi tri delegacione që të thërret në ndihmë vëllezërit shqiptarë nga Kosova dhe Peshteri, si dhe nga rrethet tjera.

Delegacionin i cili u nis për në Kosovë, e përbënin qytetarët e Pazarit të cilët ishin me namë: Hanefi Lajqi, Rasim agë Nishliu, Hazir agë Kërleshi dhe Fehim agë Hoqa. Fehim agë Hoqa ishte i lindur në Pazar, por babanë e kishte nga Kosova dhe kishte lidhje të shkëlqyeshme me udhëheqësit shqiptarë të cilët mbanin pothuajse tërë qeverisjen në Kosovë. Duke iu falënderuar ndikimit të tij u arrit ndikimi te udhëheqësit shqiptarë, si te Xhafer Deva, Pajazit Boletini, Adem Voca dhe të tjerë. Aqif Blyta me kohë armatosi popullatën. Pas marrjes së ftesës për ndihmë, 3200 shqiptar të Kosovës arritën me shpejtësi të pamenduar nëpër malet e Rogoznës, në Pazarin e Ri.

Forca të mëdha çetnike me vetëbesim kishin filluar të futen nëpër fshatra. Me shpejtësi marramendëse arritën vullnetarët nga Kosova nën udhëheqjen e Shaban Polluzhës. Në të njëjtën kohë, nga drejtimi i Dohoviqit dhe nga Ribariqi arrinin luftëtarë nga Peshteri, Bisheva dhe luftëtarët e Xhemajl Koniqaninit. Çetnikët në panik iknin në drejtim të Rashkës, nga edhe kishin ardhur. Por, në tërheqje ua kishin zënë priten afër Banjës së Pazarit, shqiptarët që kishin ardhur nga Kosova e që në tërësi i shkatërruan. Tek kriminelët e vrarë në jangjikët (çantat) e tyre u gjetën gozhda të mëdha të cilat i kishin marrë me vete që kur ta marrin në dorë qytetin, myslimanët t'i kryqëzojnë dhe t'i gozhdojnë. Luftëtarët e Peshterit, të cilët kishin arritur, i detyruan çetnikët që të tërhiqen në drejtim të Rashkës.

Shqiptarët trima i udhëhiqte legjendari Shaban Polluzha, i cili me të arritur në Duga Polanë, fshati më verior i banuar me popullsi myslimane - shqiptare - njësive, gjegjësisht forcave ushtarake dhe banorëve, me një fjalim të shkurtër po me një autoritet të pakontestueshëm, iu thotë: "Të nderuar vëllezër, kemi ardhur këtu për të kryer një mision të shenjtë; jemi këtu për t'i mbrojtur familjet e rrezikuara nga çetnikët e tërbuar. Ju, siç jeni në dijeni, kriminelët serbë kanë vrarë e masakruar popullatën e pafajshme të kësaj ane. Ne, kur kemi pasur mundësi, gjithnjë kemi ndihmuar popujt e rrezikuar. Prandaj, në këtë kontekst, duhet kuptuar këtë mision i cili në planë të parë ka karakter humanitar e njerëzor. Por, me këtë mbrojmë edhe një pjesë të shqiptarëve që jetojnë në këto anë. Uroj që lufta të na shkoj mbarë dhe besoj se kemi forcë dhe moral që t'i dëbojmë hordhitë çetnike nga Sanxhaku i përgjakur".

Ne kujtimet e Brahim Spahiut thuhet se luftëtarëve në Duga Polanë iu drejtua edhe Mulla Ilaz Brojës, i cili në kontekst të ritit fetar ka theksuar se "misioni juaj është njerëzor dhe se dikush mund të bjerë edhe në vijën e frontit, prandaj përshëndetuni me njëri-tjetrin. Te Zoti jeni të drejtë. U priftë e mbara".

Për fat të keq, në Sanxhak e edhe në Kosovë dihet pak për kontributin e Shaban Polluzhës dhe bashkëluftëtarët e tij, duke mos llogaritur qytetarët e vjetër të Pazarit të cilët me respekt të madh flasin për ato kohëra.

Në Luftën për mbrojtjen e Pazarit kanë dhënë jetën 144 luftëtar shqiptarë nga Kosova, varret e të cilëve ndodhën në varrezat më të Mëdha të Pazarit në Gazillar. Nga Peshteri dhe krahina e Rozhajës kishin arritur rreth 2000 ushtarë të udhëhequr nga Mulla Jakup Kombi (Kardoviq). Çetnikët gjatë këtyre 65 ditëve (nga 2 tetori deri më 7 dhjetor 1941), organizuan tri sulme drejt Pazarit të Ri, ndërsa policia e Pazarit, nën udhëheqjen e Haqif Blytës, kishte kryer një kundërsulm të fortë në drejtim të Rashkës.

Në këtë luftë pranë Rashkës u dallua " trimi në kalë të bardhë", Xhemajl Koniqanini, cili udhëhoqi luftëtarët e rrethinës së Tutinit. Ejup Mushoviq, në veprën e tij "Novi Pazari dhe rrethina" thotë: "Sulmi i parë ndaj Pazarit të Ri është kryer me 4 nëntor 1941. Qëllimi i sulmit ishte marrja e qytetit nën kontroll dhe shfarosja i popullsisë myslimane. Sulmi ka zgjatur nga ora 4:00 deri në ora 10:00. Ky sulm i çetnikëve ishte i pasuksesshëm. Pas këtij sulmi, Aqifi në qytet solli forca të reja dhe në shenjë hakmarrje organizoi sulmin ndaj Rashkës. Ky sulm filloi më 16 nëntor në ora 10:00 dhe u krye më 17 nëntor rreth orës 16:00. Në këtë sulm morën pjesë 2600 shqiptarë dhe boshnjak të armatosur më mirë".

Pas sulmit të parë të çetnikëve, Aqif Blyta organizoi një kundërsulm me qëllim që t'ju shkaktoj dëme të mëdha. Me këtë rast ishte i ndihmuar nga komandanti i milicisë së Tutinit, Xhemajl Koniqaninit, dhe nga vëllezërit Dreshaj. Kishin pasur mundësi ta marrin Rashkën nën kontroll, por ishin ndalur nga gjermanët që mos të bënin një gjë të tillë.

Sulmi tjetër i çetnikëve në Pazarin e Ri është kryer më 21 nëntor me forca më të mëdha sesa herën e kaluar. Ky sulm zgjati vetëm një ditë. Gjatë këtij sulmi, çetnikët i djegën të gjitha fshatrat myslimane. Kësaj here Pazari i Ri me sukses është mbrojtur. Sulmi i tretë i Pazarit të Ri ka qenë më specifik. Në këtë sulm kanë marrë pjesë edhe gjermanët, të cilët çetnikët i kishin mashtruar sepse iu kishin thënë se qytetin e kanë nën kontroll komunistët. Posa filloi sulmi, rreth orës 4:00 më 4 dhjetor, gjermanët kishin zbuluar mashtrimin dhe ishin kthyer në Rashkë bashkë me çetnikët.

Lufta për mbrojtjen e Pazarit, gjegjësisht popullsisë nga shfarosja, ishte jo vetëm veprim i duhur dhe i domosdoshëm, por edhe më tepër human. Kjo luftë është ndër luftërat e rralla në të cilën u tregua jo vetëm ndihma vëllazërore por edhe organizimi brilant i udhëheqjes së trupave mbrojtëse./*Telegrafi*

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com
Montimi
Servisim
Porosi

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# Ide të ndryshme për stadiumin kombëtar



Ende nuk dihet saktësisht se ku do të ndërtohet stadiumi kombëtar. Përveç ideve të ndryshme për vendin, ide të tjera për stadiumin kanë dhënë trajnerët në Kosovë të cilët kanë shprehur mendimin se ky stadium është i panevojshëm. Gani Sejdiu dhe Tahir Batatina kanë thënë se më mirë do të ishte zgjerimi i kapaciteteve në stadiumin "Fadil Vokrri" dhe të investohet në stadiume të tjera. Ndërsa analisti Genc Sermaxhaj ka thënë se stadiumi kombëtar duhet të ndërtohet, por në Prishtinë e jo në Drenas

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Debati për vendin se ku duhet të ndërtohet stadiumi kombëtar ka vazhduar edhe të enjten. Disa prej trajnerëve të futbollit në Kosovë e shohin të panevojshëm debatin se a duhet stadiumi të ndërtohet në Korreticë të Drenasit apo në Bërrnicë të Prishtinës, pasi ata besojnë se më mirë do të ishte të zgjerohet stadiumi "Fadil Vokrri" në Prishtinë dhe të investohet edhe në stadiumet e tjera të Superligës.

Trajneri Gani Sejdiu, që llogaritet ndër më të suksesshmit në Kosovë, ka thënë se investimi në stadiumet "Fadil Vokrri" dhe "Adem Jashari", por edhe në stadiumet e tjera do të ishte më i mirë se ndërtimi i një stadiumi kombëtar. "Mendoj se është dashur të investojmë në stadiumin 'Fadil Vokrri', që ta shtojmë kapacitetin edhe në stadiumin 'Adem Jashari', kurse disa mjete të tjera t'i investojmë nëpër stadiumet e Superligës, ku gjendja e tyre nuk është e mirë dhe, të them të drejtën, nuk i intereson akujt. Megjithatë, projekti për stadiumin nacional është madhor dhe do t'i shërbejë Kosovës për të ardhmen, por nuk është mirë të përdoret për interesa politike", ka deklaruar Sejdiu.

Të njëjtin ide e ka dhënë edhe trajneri i Llapit, Tahir Batatina, i cili ka thënë se Kosova e ka stadiumin kombëtar "Fadil Vokrri", veçse duhet zgjeruar dhe të investohet edhe në stadiumet e tjera. "Nuk kemi nevojë as për Korreticën, as për Bërrnicën, por ta zgjerojmë stadiumin tonë kombëtar 'Fadil Vokrri'. Në çdo shtet stadiumi kombëtar është në kryeqytet dhe qytete të ndryshme, ndërsa ne e kemi stadiumin, vetëm duhet ta zgjerojmë dhe me mjetet e tjera edhe Llapi, Drenica, Gjakova dhe qytetet e tjera t'i ndërtojnë stadiumet e nivelit të katërt për ndeshjet ndërkombëtare me nga 12 000 ulëse. Edhe e zhvillojmë futbollin, edhe nuk kemi anime se ku u ndërtua apo ku po ndërtohet", ka deklaruar Batatina.

Por ndryshe mendon analisti Genc Sermaxhaj. Ai ka thënë për gazetë se stadiumi duhet të ndërtohet, por jo në Drenas. Ish-futbollisti i shumë klubeve në Kosovë, ka thënë se gjithkund në botë stadiumi kombëtar është në kryeqytet. "Është shumë e rëndësishme lokacioni, por edhe ndërtimi i shpejtë i stadiumit kombëtar. Vendimet e mëhershme janë bërë në baza politike që ky stadium t'i shkojë dikujt sa me afër, edhe para derës së shtëpisë. Këto veprime janë të gabueshme dhe tani shqyrtimet për ndërtimin e këtij stadiumi janë me vend dhe me gjasë do të ndryshohet edhe lokacioni i mëhershëm. Vendi më i mirë, i duhur, komod dhe që i plotëson edhe shumë kërkesa të tjera për lojtarët, tifozët, kombëtaret dhe ekipet e tjera që vijnë në Kosovë është në kryeqytet apo afër Prishtinës. Stadiumet e kombëtareve kryesisht janë në kryeqytete. Prishtina është vendi i duhur për këtë stadium. Në të ardhmen, kur të bëhen mundësitë për ndërtimin e një stadiumi tjetër, le të ndërtohet në Gjilan, Ferizaj, Drenas, Prizren apo në një qytet tjetër", ka deklaruar Sermaxhaj.

## SHKURT

### Afati kalimtar në basketboll fillon më 2 janar

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) ka miratuar kërkesën që miniafati kalimtar dimëror të jetë nga 2 janari i vitit 2020 deri më 10 janar 2020 në ora 16:00. Ndërkohë, stinori pranveror në elitën e basketbollit do të nisë më 11/12 janar 2020.

### Mësohen çiftet e rrethit të parë të Kupës së Kosovës

Të enjten është bërë tërheqja e shortit për rrethin e parë të Kupës së Kosovës në konkurrencën e femrave. Të pranishëm në short, krahas përfaqësuesve të klubeve, ishin edhe kryetarja e Komisionit për Futbollin e Femrave, Vjollca Krasniqi, sekretari i përgjithshëm, Eroll Salihu dhe administratorja e futbollit të femrave, Valbona Gashi-Uka. Ndeshjet e këtij rrethi do të zhvillohen këtë fundjavë. Çiftet e rrethit të parë: Llapi-Malisheva, Mitrovica-A&N, Feronikeli-Kosova (P), Bazeli 2015-Vizioni, Jakova-Liria.

### Xhaka: Do të isha i lumtur nëse kthehem në klub

Situata aspak e këndshme tek Arsenali ka bërë që Granit Xhaka ta humbasë durimin pasi ka mbetur jashtë ekipit dhe nuk mund të luajë. Ngjarja e ndodhur para një muaji, ku Xhaka reagoi ashpër ndaj kontestimeve të tifozëve, duket se po i kushton mesfushorit. Që nga ai moment lojtari nuk është grumbulluar nga trajneri spanjoll Unai Emery. "Jam i qartë se si duhet të vazhdojë situata dhe Arsenali e di këtë. Kam ende një kontratë me të dhe do të isha i lumtur nëse kthehem në klub. Kështu mund të zgjidhen problemet. Do të ketë zgjidhje, pasi nuk mund ta pranojë këtë që ka ndodhur", ka thënë Xhaka.

## Superliga rikthehet me derbin Ballkani - Gjilani



PRISHTINË, 21 NËNTOR - Pas ndeshjeve të kombëtareve, rikthehet IPKO Superliga e Kosovës në futboll. Ndeshja hapëse e javës së 16 zhvillohet sot (e premte) nga ora 13:00 në Suharekë, ku dy skuadrat e para, Ballkani dhe Gjilani, ndajnë mejdanin. Gjilanit i shkon përshtati edhe rezultati i barabartë për ta mbajtur pozitën e skuadrës lidere, kurse Ballkani i Ismet Munishit ka nevojë për tri pikë që të rikthehet në krye dhe të dëshmojë edhe një herë tjetër se në këtë edicion është skuadër për titull. Të shtunën në Gjilan zhvillohet derbi në mes të Dritës dhe Llapit, kurse në tri ndeshjet e tjera përballen Flamurtari-Feronikeli, Drenica-Vushtrria dhe Prishtina-Trepça '89. Të dielën ndeshja e vetme që zhvillohet është në mes të skuadrave të fundit në tabelë, Ferizajt dhe Dukagjinit.

## Ademi: Kemi ekip më homogjen se Maqedonia



PRISHTINË, 21 NËNTOR - Maqedonia e Veriut është kundërshtare e Kosovës në gjysmëfinale të "play-off"-it të Ligës D të Kombeve, fituesi i së cilës ligë do të shkojë në "Euro 2020". Përzgjedhësi Bernard Challandes ka marrë shënime për ta studiuar mirë kundërshtarin nga shteti fqinj. Ndërsa kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, beson se Kosova do ta kalojë pengesën e quajtur Maqedonia e Veriut në fund të muajit mars. "Po, ishim në Shkup për ta ndjekur ndeshjen Maqedonia e Veriut - Izraeli. Ju e dini se Maqedonia e Veriut është kundërshtarja jonë në gjysmëfinale të Ligës së Kombeve. Ndeshja nuk ishte me peshë që ta kuptojmë fuqinë e saj, megjithatë nuk është ekip për t'u nënçmuar", ka thënë Ademi për gazetën "Lajm" nga Maqedonia. "Besoj se ne kemi ekip më homogjen sesa që ka Maqedonia e Veriut. Ndeshja duhet të luhet në Shkup", ka deklaruar Ademi.

# Në Kosovë do të organizohet Festivali i Filmit Sportiv



PRISHTINË, 21 NËNTOR - Komiteti Olimpik i Kosovës ka organizuar të enjten takim me regjisorë, producentë, skenaristë dhe gazetarë sportivë, me rastin e shënimit të 21 nëntorit - Ditës Botërore të Televizionit. Në takimin e mbajtur në "Hotel Sirius" në Prishtinë u diskutuan tema të ndryshme në lidhje me sportin, filmin, dokumentarët sportivë etj.
Kryetari i KOK-ut, Besim Hasani, ka njoftuar se KOK-u është bërë anëtar i 121-të i Federatës Ndërkombëtare të Kinemasë Sportive dhe Televizionit (FICTS). "Arsyeja kryesore që ju kemi ftuar është të fillojmë një bashkëpunim për realizimin e filmave që kanë të bëjnë me sukseset e sportistëve të Kosovës dhe sportit në përgjithësi. Me anëtarësimin në FICTS ne qysh nga viti i ardhshëm do ta organizojmë Festivalin e Filmit Sportiv për herë të parë në Kosovë, ku do të bëhemi njëra nga 16 shtetet organizatore të këtij Festivali", ka thënë Hasani, sipas të cilit, filmat e përzgjedhur do të garojnë në Kampionatin Botëror të Filmit Sportiv, që FICTS e organizon çdo vit në Milano të Italisë. Profesori dhe regjisori i njohur Fadil Hysaj ka thënë se vetëm me filma dhe dokumentarë mund t'i tregojmë botës përjetimet e historive të ndryshme që ka populli ynë, derisa si storie mori shembull mikpritjen madhështore që tifozët e Kosovës ia bënë Kombëtares së Anglisë në futboll gjatë fundjavës së kaluar. Në emër të Shoqatës së Gazetarëve Sportivë të Kosovës, kryetari Edmond Thaçi shprehu mbështetjen e ShGSK-së për të gjithë ata që do të marrin iniciativa për realizimin e filmave dhe dokumentarëve sportivë. Sekretari i përgjithshëm i KOK-ut, Shasivar Haxhijaj, propozoi që të bashkëpunohet edhe me Qendrën Kinematografike të Kosovës (QKK). Me diskutime të frytshme kontribuuan edhe gazetarët Gani Kosumi, Artan Muhaxhiri, Arlind Grantolli, si dhe regjisorët e producentët e tjerë: Florent Mehmeti, Arben Kastrati, profesori Sadik Krasniqi. Në fund u formua edhe Këshilli Iniciues për të gjitha propozimet e dhëna si dhe për organizimin e Festivalit të Filmit Sportiv në Kosovë.

# Clippersat triumfojnë në shtesë, San Antonio në krizë

UASHINGTON, 21 NËNTOR - Skuadra kampione e Torontos vijon paraqitjet e mira në kampionat, duke fituar 113-97 ndaj Orlandos, sfidë e dominuar nga kanadezët. Van Vleet me 24 pikë ishte shënuesi më i mirë për Toronton, që ngjitet në vendin e katërt në Lindje. Dallasi i jep një leksion të fortë skuadrës së Golden State, duke fituar me rezultat 142-94, duke zhytur gjithnjë e më shumë në krizë nënkampionët e NBA-së. Tjetër ndeshje e mirë për Donqiq, që realizoi një "triple-double", 35 pikë, 10 rebounde e 11 asistime. Koha shtesë ka qenë me fat për skuadrën e Clippersave, që fitoi ndaj Bostonit (107-104), ndeshje me rivalitet deri në fund. Sfidë ku të dyja ekipet e meritonin fitoren, por në fund diferencën e bëri Lou Williamsi nga stoli, shënuesi më i mirë me 27 pikë. Humbet edhe skuadra e Houstonit që u mund 105-95 nga Denveri, një përballje mes dy ekipesh pretendente në Perëndim.



**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| Philadelphia - New York | 109-104 |
| Washington - San Antonio | 138-132 |
| Atlanta - Milwaukee | 127-135 |
| Brooklyn - Charlotte | 101-91 |
| Dallas - Golden State | 142-94 |
| Miami - Cleveland | 124-100 |
| Toronto - Orlando | 113-97 |
| Chicago - Detroit | 109-89 |
| Minnesota - Utah Jazz | 95-103 |
| Denver - Houston | 105-95 |
| Clippers - Boston | 107-104 |

## SHKURT

### Mane: Kloppi, trajneri më i mirë në botë

Sulmuesi i Liverpoolit, Sadio Mane, nuk ka dyshime se Jurgen Kloppi është trajneri më i miri në botë. Senegalezi beson se meritat për përparimin e madh të Liverpoolit duhet t'i shkojnë strategut gjerman. "Unë do të luftoja të përshkruaj se sa i suksesshëm ka qenë ai për Liverpoolin. Të gjithë mund të shohin se çfarë ka bërë ai për këtë klub, për këtë qytet dhe cilësinë që ai ka si menaxher", ka thënë Mane. "Ka shumë menaxherë të mirë në Evropë, por ajo që mund të them është se menaxheri ynë gjithmonë ka fjalët e duhura dhe gjërat e duhura për ta menaxhuar ekipin e tij, veçanërisht duke ditur si të merret me ekipin e tij. Gjithmonë do t'i besoja ndikimit të tij në ekip. Ai është një fitues dhe unë do të thosha që ai është më i miri në botë", ka deklaruar Mane.

### Mourinho i vuri kusht Tottenhamit mos ta shesë Kanen

Dy gazetat prestigjioze "Daily Telegraph" dhe "Daily Express" zbulojnë një prapaskenë interesante rreth firmës së Jose Mourinhos me Tottenham Hotspurin. Përpara se të pranonte të bëhej trajneri i ri i gjelave të Londrës, "Special One" i ka kërkuar presidentit Daniel Levy ta mbajë në skuadër sulmuesin Harry Kane dhe ta refuzojë çdo ofertë që mund të vijë në merkaton e verës në drejtim të sulmuesit anglez. Kane është në qendër të projektit të Mourinhos, i cili ka firmosur për tre vjet e gjysmë me "spurs"-at. Edhe pse kërkohet nga Reali i Madridit, portugezi ka marrë premtimin se gjiganti i sulmit do të qëndrojë në skuadër edhe për vitet në vazhdim.

### Bayerni e Barcelona në garë për Pochettinon

Mauricio Pochettino është shkarkuar nga detyra e trajnerit të Tottenham Hotspurit të martën, por ai shumë shpejt mund të bëhet me skuadër të re. "Th Sum" raporton se trajneri argjentinas është synim i Bayern Munchenit dhe Barcelonës. Në këto çaste duket se gjasat më të mëdha për ta angazhuar Pochettinon i ka skuadra e Bayernit.

### De Ligt: Nuk jam penduar që kalova te Juve

Matthijs De Ligt i është kundërpërgjigjur Patrick Kluivertit lidhur me çështjen e transferimit në Juventus. Mbrojtësi holandez ka thënë se nuk i ka rënë pishman që vendosi t'i bashkohet gjatë verës "Zonjës së Vjetër". "Nuk jam penduar aspak që kalova te Juventusi. Ajo që ka thënë Kluivert është thjesht një hamendësim", ka thënë mbrojtësi holandez.

### FIA heton Ferrarin për mashtrim

Si të mos mjaftonin rezultatet negative, Ferrari përfshihet tani në valën e një skandali mashtrimi që, nëse do të faktohet si i tillë, do të ketë pasoja në imazhin dhe sezonin e një prej ekipeve ikonike te Formula 1. FIA ka nisur një hetim për sistemin e furnizimit të makinave të linçencuara për të garuar, madje ka sekuestruar për analiza edhe disa pjesë të dyshimta, përmes komisarëve të saj, pjesë të përdorura në garën e fundit në Brazil. Sistemet e furnizimit do të analizohen në laboratorët e FIA-s pasi dyshohet se janë modifikuar dhe janë përdorur për të avantazhuar pilotë në krahasim me protagonistë e tjerë në cirkuit. Edhe pse nuk ka pasur asnjë ankesë zyrtare, disa ekipe të Formula 1 kanë ngritur dyshime se si Ferrari arrin një shpejtësi jashtë logjikës në vijë të drejtë, diçka që nuk e kishte para pauzës së verës. I vetmi që ka zbritur në skenë me akuza direkte për mashtrim është Maks Verstapen, një prej pilotëve që synon të përfshihet në projektin e ardhshëm të Ferrarit. Dy pilotët e skuadrës italiane e nisën në pozicione të mira garën e Brazilit, por asnjë prej tyre nuk arriti ta përfundonte pasi u përplasën me njëri-tjetrin duke mos mbijetuar deri në fund.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA

**DREJTORIA E ARSIMIT**
**05nr. 1095 datë 21.11.2019**

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212 , nenit 35 të Ligjit për arsimin parauniversitarnë Republikën e Kosovës me nr. 04/L-032 , nenit 5 të Ligjit për arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068 , UA nr.10/2018 (Normativit mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm),UA nr.05/2018(Normativit për mësimdhënësit e arsimit profesional),Udhëzimit administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e mardhënies së punës në sektorin publik,Drejtoria Komunale e Arsimit shpall këtë:

**KONKURS**

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për vitin shkollor 2019/2020

**1. SHFMU "Hasan Prishtina"-Semetishtë**
- Një mësimdhënës/e për lëndën e Historisë për 8 orë mësimore si dhe 4 orë në SHFMU "28 Nëntori" - Doberdelan.

**2.SHFMU "Gj.K Skenderbeu" – Sallagrazhdë**
- Një mësimdhënës/e për lëndën e Programit Fillor (Zëvendësim i pushimit të lehonisë).

**3. SHFMU "Ismet Jashari -Kumanova" – Javorë**
- Një mësimdhënës/e për lëndën e Programit Fillor.

*Kushtet*: Për këto vende të lira të punës të shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale sipas normativit UA-MASHT nr.10/2018 .

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:
- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilën e plotëson kandidati
- Diplomat e shkallës së kualifikimit ose certifikata në vend të diplomës e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë muaj (fotokopje ).
- Ekstrakti i lindjes
- Letërnjoftimin (fotokopje)
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim, (nëse ka)
- Certifikatat për trajnimet e kryera të akredituara nga MASHT(nëse ka)

-Dokumentet e kompletuara dorëzohen të fotokopjuara, ndërsa dokumentet origjinale prezantohen në intervistë. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni.
Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyren Pritëse në Komunën e Suharekës.
Afati i konkurrimit 15(pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit të konkursit në gazetë.

**Për orarin e itervistimit do të informohuni në web faqen e Komunës të Suharekës dhe tabelës së shpalljeve të DKA-së.**

Drejtori i DKA-së
Remzi Bytyqi

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA

DIREKCIJA ZA OBRAZOVANJE
**05br .1095 datum: 21.11.2019**

Na osnovu člana 8. Zakona o radu 03 / L-212, člana 35 Zakona o obrazovanju u Republici Kosova br. 04 / L-032, člana 5 Zakona o obrazovanju u opštinama Republike Kosova br. 03 / L-068, AU br.10 / 2018 (Normativa o stručnim kadrovima opšteg obrazovanja), Administrativno uputstvo br.07 / 2017 o regulisanju procedure za zasnivanje radnnog odnosa u javnom sektoru, Opštinska direkcija za obrazovanje objavljuje sledeće:

KONKURS

Za popunu slobodnih radnih mesta

**1. OSNŠ " Hasan Prishtina"-Semetišt**
- Jedan nastavnik za predmet istoria za 8 časova i 4 časova u OSNŠ "28 Nëntori" - Doberdelan

**2. OSNŠ "GJ.K.Skënderbeu " Sallagrazhde**
- Jedan nastavnik za razredu nastavu (zamena nastavnice na porodiljsko odsustvo).

**3. OSNŠ "Ismet Jashari -Kumanova" – Javorë**
- Jedan nastavnik za razredu nastavu .

Uslovi: -Za slobodna radna mesta objavljenih na konkursu za nastavnika traži se odgovarajuća stručna sprema prema normative AU MONT br.10 / 2018.
Potrebna dokumentacija za prijavu na konkurs:
-Obrazac za prijavu(zahtev)koji popunjava kandidata
Diploma o stepenu stručne spreme ili uverenje umesto diplome koja ne sme biti starija od šest meseci (fotokopija).
-Izvod rođenih
-Lična karta (fotokopija)
- Serifikati o završenim obukama akreditovanih od strane MONT-a(ako ga poseduje)
-Potvrda o radnom iskustvu u obrazovanju, (ako ga poseduje)
- Kompletirana dokumenta se dostavljaju fotokopirana, dok se originalna dokumenta predstavljaju u intervjuu. Komisija neće razmatrati nekompletirana i dokumenta koja se predaju nakon isteka utvđenog roga.Izabrani kandidata iz uže liste biče podvrgnuti testiranju i intervistiranju.
Kontaktirače se samo izabrani kandidati iz uže liste
Aplikacije se uzimaju i dostavljaju u Kancelariji za prijem u opštini Suva Reka.
Rok za podnošenje prijave je 15 (petnaest) dana od dana objavljivanja u javnim medijima informisanja.
Za raspored održavanja intervjua bičete informisani preko WEB Komuna i oglasne table.

Direkcija za obrazovanje

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "FOLGORE SECURITY INTERNATIONAL" L.L.C. Dega në Kosovë, Gjakovë ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NRB. Biznesit 71061485 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "FOLGORE SECURITY INTERNATIONAL" L.L.C. Dega në Kosovë donelo odluku o prestani rada sa bisnisom: NRB. Biznesit: 71061485 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the ""FOLGORE SECURITY INTERNATIONAL" L.L.C. Dega në Kosovë has come to the decision to quit its business: NRB. Biznesit: 71061485, the company has appointet a likuidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager - mortgage accounts in this company are kindly request to shoë up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 3029 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 3
Data / Datum / Date: 21.11.2019 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Ref. Nr. Pejë, 21.11.2019

Me bazë në nenin 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, UA nr. 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës nr. 04/L-037, nenin 169, 170, 171, 172, 173, 174, të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë nr. 04-V-622, Rregulloren për të Ardhurat Personale të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë ref. nr. 1944/16, e dt. 05.10.2016, Rregulloren për Procedurat Përzgjedhëse Lidhur më Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik të Rregullt në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, nr. 754, dt. 01.04.2019, Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbledhjen e mbajtur me datë 08.11.2019, nxjerri vendim sipas të cilit:

**UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" në Pejë**
**shpall**
**K O N K U R S**
**për emërimin e personelit akademik të rregullt në UHZ**

**I. Konkursi për shpalljen e pozitave në vijim:**

**FAKULTETI I BIZNESIT**

**Mësimdhënës**

**Mësimdhënës në Drejtimet në Gjuhën Boshnjake:**

1. Një mësimdhënës për lëndët: Shkrim Akademik, Metodologjia e Punës Kërkimore – Shkencore, Mjedisi i Biznesit Ndërkombëtar, Komunikimi në Biznes, Ekonomia e UE – së dhe Kosova;

**FAKULTETI JURIDIK**

**Mësimdhënës**

1. Një mësimdhënës për grup lëndësh Civile;
2. Një mësimdhënës për grup lëndësh Administrative – Kushtetuese;
3. Një mësimdhënës për grup lëndësh Penale;

**FAKULTETI I MENAXHIMIT NË TURIZËM,HOTELERI DHE MJEDIS**

**Mësimdhënës**

1. Një mësimdhënës për Lëndët: Menaxhimi i Udhëtimeve Turistike (MTHM), Menaxhimi i Shpërblimit të Performancës (FB), Hulumtimi i Tregut Turistik (MTHM), Menaxhimi i Turizmit dhe Hotelerisë (MTHM);

**FAKULTETI I AGROBIZNESIT**

**Mësimdhënës**

1. Një mësimdhënës për Lëndët: Bazat e Pemëtarisë, Bazat e Vreshtarisë dhe Degradimi i Tokës, Mekanizimi Bujqësor;
2. Një mësimdhënës për Lëndët: Biokimia (TU, TPB, AA), Përpunimi dhe Ruajtja e Pemëve dhe Perimeve, Ambalazhimi dhe Ruajtja e Produkteve Ushqimore, Provim Formimi;

**FAKULTETI I ARTEVE**

**Mësimdhënës**

1. Një mësimdhënës për Lëndët: Njohje Instrumentesh I - II, Folklor I – II, Etnomuzikologji I – II, Analizë e Stileve Muzikore I – II;
2. Një mësimdhënës për Lëndët: Saksofon I – II – III – IV – V – VI – VII - VIII, Pedagogji në Instrument Frymor I – II, Praktika Artistike - Recital Grup Koncert I – II – III;

**I. KUSHTET E PËRGJITHSHME**

1. Emërimi i personelit akademik do të bëhet në pajtim më Ligjin Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, dispozitat e Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, si dhe Rregulloren për Procedurat Përzgjedhëse Lidhur më Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik të Rregullt në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, nr. 754, dt. 01.04.2019.

II. Kandidatët të cilët aplikojnë për mësimdhënës duhet të kenë së paku gradën doktor të shkencave (ekuivalente me të në Fakultetin e Arteve) në fushën përkatëse, si dhe të plotësojnë kushtet tjera siç parashihen në nenin 171, 172 dhe 173, të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.

**II. KUSHTET PËR APLIKIM:**

1. Kandidatët të cilët aplikojnë për mësimdhënës duhet t'i paraqesin këto dokumente: kërkesën me biografi, kopjet e diplomave përkatëse të noterizuar, certifikatën e lindjes, dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale, dëshmi të organeve kompetente që nuk është nën hetime si dhe informatat e tjera specifike shtesë, të cilat janë të rëndësishme për ata që aplikojnë; ndërsa, ata të cilët janë të punësuar në Institucione të Arsimit të Lartë (Universitete) duhet ta paraqesin edhe vendimin e zgjedhjes së fundit.
2. Kandidatët të cilët aplikojnë për me shumë se një pozitë duhet të sjellin kopje fizike për aq pozita sa aplikojnë.
3. Kandidatët të cilët dëshmojnë se njohin gjuhën angleze, frënge apo gjermane kanë përparësi si aplikues.
4. **Kandidatët që kanë mbaruar studimet bachelor, master ose doktoratës jashtë vendit, duhet të sjellin edhe dëshmi nga MASHT përkatësisht kopjen e vendimit për nostrifikimin të noterizuar të diplomës përkatëse, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.**
5. Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e shpalljes në web-faqen zyrtare të Universitetit dhe gazetë, respektivisht deri më 06.12.2019.
6. Aplikacionet e plotësuara së bashku me kopjet e dëshmive të nevojshme sipas konkursit, duhet fillimisht të dorëzohen në formë elektronike në e-mail: aplikо.online@unhz.eu dhe pastaj në formë fizike në zyrën e protokollit në Rektorat nga ora 09:00-15:00. Aplikacionet e dërguara pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në faqen e internetit në këtë adresë: http://www.unhz.eu

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 3029 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 3
Data / Datum / Date: 21.11.2019 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Protokol. Br. Peć , 21.11.2019

Na osnovu člana 8. Zakona o radu br. 03 / L-212, UA br. 07/2017 o regulisanju konkursne procedure u javnom sektoru, član 26. Zakona o visokom obrazovanju na Kosovu, br. 04 / L-037, člana 169, 170, 171, 172, 173, 174, statuta Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći, br. 04-V-622, uredbe o ličnom dohotku Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći br. Pro. 1944/16, dt. 05.10.2016, Pravilnika o postupku procjene za izbor, reizbor i napredovanje redovnog akademskog osoblja na Univerzitetu " Haxhi Zeka " u Peć-i, br. 754, dt. 01.04.2019, Senat Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći, na sjednici održanoj dana 08.11.2019, donio je odluku prema kojoj:

**UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" Peć**
**objavljuje**
**K O N K U R S**
**za izbor redovnog akademskog osoblja na UHZ**

**I. Konkurs se objavljuje na sledećim pozicijama:**

**FAKULTET BIZNESA:**

**Nastavnik za predmete na bosanskom jeziku ;**

Jedan nastavnik za predmete; Akademsko pisanje, Metodologija znanstvenog istraživačkog rada, Međunarodno poslovno okruženje, Komunikacije u biznisu, Pravo EU i Kosova.

**PRAVNI FAKULTET**

**Nastavnik za predmete ;**

1. Jedan nastavnik za grupu civilnih predmeta ;
2. Jedan nastavnik za grupu administrative – ustavnih predmeta;
3. Jedan nastavnik za grupu kriminalnih predmeta ;

**FAKULTET ZA MENADŽMENT U TURIZMU, UGOSTITELJSTVU I OKOLIŠU**

**Nastavnik za predmete ;**

1. Jedan nastavnik za predmete; Menadžment turističkih putovanja (MTHM), Uprava ocjenjivanja rada (FB),Istraživanje turističkog tržišta (MTHM), Menadzment u turizmu i ugostiteljstvu (MTHM);

**FAKULTET AGROBIZNISA**

**Nastavnika za predmete:**

1. Jedan nastavnik za predmete: Osnove Šumarstva, Osnove za vinogradarstvo i degradacije zemljišta, Poljoprivredne mehanizacije;
2. Jedan nastavnik za predmete: Biohemija (TU, TPB, AA), Prerada i očuvanje voća i povrća , Pakovanje i čuvanje prehrambenih proizvoda, Obuke ispit;

**FAKULTET UMJETNOSTI**

1. Jedan nastavnik za predmete: Poznavanje instrumenta I-II,Folklor I - II, Etnomuzikologija I - II, Analizu glazbenih stilova I – II, III.
2. Jedan nastavnik za predmete: Saksofon I - II- III - IV - V - VI - VII - VIII, Obrazovanja u duvacki instrument I - II, Umjetničke prakse - recital koncert grupa I- II - III;

**II. OPŠTI USLOVI**

1. Izbor akademskog osoblja vrši se u skladu sa Zakonom br. 04 / L-037 o visokom obrazovanju u Republici Kosovo, u skladu sa dispozicijama Statuta Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći, Pravilnika za Procedure vrednovanja o reizboru i unapređivanje akademskog osoblja Pro. Br. 754 dt. 01.04.2019 na Univerzitetu "Haxhi Zeka" u Peći.

2. Kandidati koji apliciraju za nastavnika mora imati najmanje diplomu doktora nauka (Ekvivalent - Fakulteta likovnih umjetnosti) u odgovarajućoj oblasti i da ispunjavaju druge uslove kao što je navedeno u članu 171,172 i 173, Univerziteta "Haxhi Zeka "u Peći.

**III. USLOVI ZA APLICIRANJE**

1. Kandidati koji se prijavljuju za nastavnika moraju dostaviti sljedeće dokumente: zahtjev sa biografijom, ovjerene kopije relevantnih diploma, izvod rođenih, dokaz o naučnim i stručnim publikacijama, dokaz od nadležnih organa da nije pod istragom, kao i druge dodatne specifične informacije, koje su važne za one koji se prijavljuju; dok oni koji su zaposleni na Fakultetu treba da dostave odluku o posljednjem izboru.

2.Kandidati koji se prijavljuju za više od jedne pozicije moraju dostaviti fizicki toliko primjerak za svaku poziciju za koju aplicira.

3. Kandidati koji dokažu da znaju engleski, francuski ili njemački jezik imaju prednost kao aplikant.

**4. Kandidati koji imaju doktorat, magisterij ili koji su završili master u inostranstvu moraju također priložiti dokaze za provjeru relevantnih diplomu iz MONT-a, naprotiv odluku o nostrifikaciji određene diplome, u suprotno, dosje od podnosioca će se smatrati nepotpunim.**

5.Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja na službenoj web- stranici Univerziteta i novinama, tačnije do 06.12.2019.

6. Ispunjene aplikacije zajedno sa kopijama potrebnih dokaza na osnovu konkursa , trebaju se poslati u elektronskoj formi na e-mail:apliko.online@unhz.eu a onda i predati u kancelariji protokola u Rektoratu od 09:00-15:00 h.
Aplikacije poslane posle roka kao i one nekompletne neće se razmatrati.

Konkurs možete pronaći objavljen i na web stranici na adresi:
http://www.unhz.eu

Ambienti

**Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti"Sh.A me adresë : Rr.Xhem Sadrija P.n Pejë**

**Bazuar ne ligjin e Punës Nr.03/L-212 të dt. 02.11.2010, neni 8 dhe në bazë të Udhzimit Administrativ Nr. 07 / 2017. Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti"Sh.A .Pejë publikon këtë :**

# K O N K U R S

## Për per plotësimin e vendeve te lira te punës

**Pozita: Dy (2) Inkasant**

**Detyrat dhe përgjegjësit:**

1. Bënë inkasimin nga shfrytëzuesit e shërbimeve dhe ngarkohet materialisht
1. me fatura sipas rrugëve dhe reoneve
2. Për çdo ditë dorëzon pazarin ditor dhe ngarkohet me fatura.
3. Plotëson fletëdorëzimin mbi kryerjen e pagesave me shënimet e duhura.
4. Përcjell gjendjen në teren për zbulimin e sipërfaqeve në sektorin private dhe
5. bënë evidencën e tyre dhe me shkrim e informon shefin e shërbimit.
6. Është i obliguar që të përcjellë ndrrimin e pronarit të banesave, shtëpive dhe të
7. merr shënimet të cilat i dorëzon shërbimit komercialo-financiar.
8. Është i obliguar që për çdo parregullsi në fatura, t'i kthej në rillogaritje.
9. Obligohet që në teren të sillet korrekt dhe të mban uniform apo shenjë
10. identifikimi të Ndërmarrjes.
11. Kryen edhe punë tjera me urdhëres të Shefit të inkasantëve, Pergjegjesit Financiar dhe Menaxherit të Operatives .
12. Për punën e vetë i përgjigjet drjtëpërdrejt Shefit të Inkasimit.

**Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara**

**Kualifikimi:**
-Shkolla e Mesme / Diplomë universitare
-Njohja e punës me kompjuter
- 2 vite përvojë pune
Aftësia e komunikimt

**Dokumentacioni i kërkuar :**
- Shkolla e Mesme / Diplomë universitare
- Biografinë (CV) e detajuar
- Letër motivimin
- Deklaratën nën betim
- Çertifikatën që nuk është nën hetime

Pozita : (1) Inspektor I brendshëm

**Detyrat dhe përgjegjësit:**

1. Inspekton terenin se a është bër dorzimi I faturave te konsumatoret .
2. Inspekton terenin se a është bër përditsim i te dhënave për konsumatoret , siguron qe borxhi I konsumtorve të precizohet , dhe te mos bartet nga një person tek tjetri pa e rregulluar borxhin i e më parshëm.
3. Bën inspektimin, monitorimin dhe rishikimin e aktiviteteve të inkasantve .
4. Regjistron në programin e ndermarrjes konsumatoret, si Emrin , Emrin e Prindit, Numrin personal të konsumatorit dhe të dhënat për bizneset sipas çertifikates së biznesit ,keto shenime pranohen nga inkasantet , dhe të kontrollohen nga inspektora se a janë plotsuar kushtet per regxhistrim .
5. Komunikon brenda institucionit dhe jashtë tij për shërbim më të mir për konsumatoret .
6. Në bazë të konstatimit të gjendjes reale, dhe të gjeturave në teren , raporton tek mbikqyrsi I tij
7. Punon planet dhe raportet ditor , mujore dhe vjetore të punës.
8. Kontrollon dhe verifikon rekapitulimin e shpenzimeve dhe pagesës sipas
9. regjioneve në aspektin finansiar
10. Angazhohet drejtëpërdrejt me rastin e zgjedhjes së kontesteve të faturimit dhe reklamimeve nga ana e konsumatorëve dhe është përgjegjës për dhënjen e shënimeve të duhura për zgjidhjen e këtyre kontesteve.
11. Udhëheq punën në lidhjen e kontratave me konsumatorë dhe zbulimin e konsumatorë ve të rinjë privat dhe të biznesit.dhe regjistrimin e tyre në dosje të konsumatorëve.
12. Kryen edhe punë tjera me urdhëres të Sekretarit , dhe Kryeshefit Ekzekutiv.
13. Për punën e vetë i përgjigjet drjtëpërdrejt Sekretarit.

**Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara**

**Kualifikimi:**
-Shkolla e Mesme / Diplomë universitare
-Njohja e punës me kompjuter
- 2 vite përvojë pune
Aftësia e komunikimt

**Kandidatëte e interesuar duhet ti sjellin keto dokumenta për aplikim**

- Shkolla e Mesme / Diplomën universitare
- Biografinë (CV) e detajuar
- Letër motivimin
- Deklaratën nën betim
- Çertifikatën që nuk është nën hetime

Pozita ; (1) Sekretaresh

**Detyrat dhe përgjegjësit:**

1. Mban evidence nga marrëdhënja e punës, libri amzë, dosjet e punëtorëve.
1. 2.Kujdeset për mbajtjen në rregull dhe ruajtjen dhe përdorimin e vulave dhe
2. 3.dosjeve të punëtorëve.
3. 4.Mban evidence lidhur me punëtorët të cilët themelojn marrëdhënje pune në
4. kohë të caktuar.
5. 5.Pranon, ekspedon postën sektorëve dhe njësive punuese, personave
6. përgjegjës,nëpërmjet librit të ekspedimit.
7. 6.Mban protokolin e Ndërmarrjes dhe librat e dorëzimit.
8. 7.Klasifikon dhe rradhitë lendët e kryera dhe i vendos në pjesën e arkivit për ruajtjen e
9. tyre
10. 8.Përgjigjet thirrjeve telefonike dhe jep lidhjen në lokalet e Ndërmarrjes dhe
11. jashtë
12. 9.Kujdeset për përdorimin ekonomik të telefonave-Faksit dhe i ndalohet
13. rreptësisht përgjimi i telefonave.
14. 10.Njofton punëtorët dhe palët me shpallje e njoftime të ndryshme
15. 12.Kujdeset për rregullsin në zyren e Kryeshefit Ekzekutiv dhe Drejtorit të
16. 13.Sektorit që i takon, pret mysafirët dhe i drejton në zyret e zyrtarëve sipas
17. nevojës.
18. 14.Kryen edhe punë tjera sipas urdhëresës të Sekretarit të Ndermarrjes .
19. 15.Për punën e vetë i përgjigjet drejtëpërdrejtë Sekretarit të Nermarrjes dhe
20. Kryeshefit ekzekutiv.

**Kualifikimi:**
- Diplomë universitare
-Njohja e punës me kompjuter
- 2 vite përvojë pune .
-Aftësia e komunikimt me pale.

**Kandidatëte e interesuar duhet ti sjellin keto dokumenta për aplikim**

- Diplomën universitare
- Biografinë (CV) e detajuar
- Letër motivimin
- Deklaratën nën betim
- Çertifikatën që nuk është nën hetime

Pozita : (1) Shef i Sigurim

**Detyrat dhe përgjegjësit:**

1. 1.Udhëheq dhe organizon mbrojtjen e të gjitha objekteve dhe pasuris së
2. Ndërmarrjes
3. 2.Bënë mbikqryerjen dhe kontrollën e punës të shërbimit të sigurimit dhe librave
4. të ndrrimit të punëtorëve të sigurimit.
5. 3.Kujdeset për rregullsin e mjeteve për mbrojtjen në punë dhe mbrojtjen kundër
6. zjarrit.dhe mban evidence lidhur me to.
7. 4.Kontrollon shpenzimet e automjeteve dhe disciplines së punëtorëve në punë,
8. si dhe paraqet fletëparaqitjen për shkeljen e obligimeve në punë nga ana e
9. 5.punëtorëve si dhe evidenton rastet e lëndimeve në punë.
10. 6.Kryen edhe punë tjera me urdhëres të Sekretarit Kryeshefit Ekzekutiv.
11. 7.Për punën e vetë i përgjitgjet drejtëpërdrejtë Sekretarit .
12. 8.Drejtëpërdrejt kontakton me organet e Policis nga fushëveprimtaria e vet.

Kualifikimi:
- Shkolla e Mesme / Diplomë universitare
-Njohja e punës me kompjuter
- 2 vite përvojë pune .
-Aftësia e komunikimt me pale.

Përveq kushteve të përgjithëshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

Çertifikatë- Kompani Sigurimit

Kandidatëte e interesuar duhet ti sjellin keto dokumenta për aplikim
- Diplomën universitare
- Biografinë (CV) e detajuar
- Letër motivimin
- Deklaratën nën betim
- Çertifikatën që nuk është nën hetime

**Informata të prgjithshme :**
**-** Konkursi mbetet i hapur 15 ditë.
-Ndërmarja ofron mundësi të barabart punësimi ,inkurajon dhe promovon angazhimin e puntëtorëve , pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe gjinive të ndryshme .

**-Mënyra e Aplikimit : Aplikacioni merret në ndërmarrje Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti"Sh.A me adresë : Rr.Xhem Sadrija P.n Pejë, Dokumentacioni duhet të dorëzohet në pliko të mbyllura në të cilin duhet të shkruhet pozita për të cilën aplikon .Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pa vlefshëm.Dokumentet duhet të dorzohen vetëm në kopje pasi të njëjtat nuk ju kthehen .Dokumentet origjinale mund të kërkohen , sipas nevojës .**










## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Argjend Dajaku, shpall të pavlefshme diplomën e SHMT "Anton Çetta"- drejtimi makineri, Skenderaj.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

▶ Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

▶ Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shiheni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.

▶ Shesim banesën dy dhomëshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit , çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387

▶ Lëshoj banesën e pamobiluar (garsonierë) me qira. Banesa, e cila gjendet rrugës për në Gërmi, 150 metra afër Kolegjit Amerikan A.U.K, ndodhet në katin 5. Çmimi 130 euro. Tel: 049/705-503 dhe 049/662-211.

▶ Lëshoj garsonierën me qira 13 m2 kati i IV (katër) në Lagjen Ulpiana. Çmimi 150 euro. Për info: 044/637-546.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Ulpiana objekti C7 kati i 3 hyrja e II-të nr 11 ka 50 m2 dy dhomshe , një banjo, kuzhinë të gjitha të reja, është e përshtatshme për zyre edhe apo ordinancë. Për informata nr tel; 044/641-524 dhe + 46705793508.


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues